Nr.	Kodi i Kualifikimit Profesional	Emërtimi i kualifikimeve	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Kodi në LKP	Përshkrim standard profesioni	Përshkrim Lista Kombëtare e Profesioneve
1	A-II-21	Teknologji ushqimore	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës në teknologjinë ushqimore	751	Ndihmës teknologu/ja ndihmon në organizimin e aktiviteteve ditore të punës sipas sektorëve përkatës, duke respektuar kërkesat dhe rregullat për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, zbaton të gjitha kërkesat në lidhje me higjienën në ambientet e punës dhe higjienën personale, si dhe monitoron pranimin e lëndëve të para e atyre ndihmëse duke u mbështetur në kërkesat standarde për cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore. Ai/Ajo merr pjesë në procese ndihmëse në përpunimin, përgatitjen, paketimin, ruajtjen, magazinimin dhe shpërndarjen e produkteve të gatshme duke zbatuar kërkesat për cilësinë e sigurinë ushqimore, sipas fushave ku punon në industrinë e përpunimit të qumështit, mish- peshkut, në industrinë e përgatitjes së brumërave, pijeve apo të përpunimit të frutave dhe perimeve, duke përdorur makineritë dhe pajisjet të thjeshta, sipas manualeve përkatëse të firmave prodhuese. Ndihmës teknologu/ja zbaton kërkesat dhe merr përgjegjësitë në mbrojtjen e mjediset, trajtimin dhe ndarjen e mbetjeve teknologjike, magazinimin dhe largimin e tyre në vendet e paracaktuara. Ai/ajo zbaton rregullat e punës në grup, komunikon me kolegë dhe me eprorë në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi.	
2	A1-III-22	Teknologji e përpunimit të brumërave	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor i përpunimit të brumërave	7512, 7513 dhe 7514	Punonjësi/ja për produkte brumi merret me prodhimin e miellit, bukëve të llojeve të ndryshme, asortimenteve të ëmbla, të kripura, makaronave, si dhe me pjekjen, ambalazhimin dhe ruajtjen e tyre. Ai/Ajo siguron bazën e nevojshme materiale dhe përgatit makineritë apo pajisjet për punë duke zbatuar rregullat e ruajtjes dhe sigurisë ushqimore. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme shërbimi ushqimore, në shoqëri tregtare që kanë reparte të shërbimit ushqimor, apo edhe të vetëpunësohet. Punonjësi/ja për produkte brumi kryen matje dhe peshime, hedhje të lëndëve të para dhe ndihmëse në brumatrice, përzierjen, nxjerrjen e brumit nga brumatricja, prerjen, presimin, tharjen, formimin, hapjen e brumit, fermentimin, lyerjen dhe dekorimin, pjekjen, ambalazhimin, sistemimin, reklamimin dhe promovimin. Përpara prodhimit, ai/ajo lexon dhe interpreton recepturën, diskuton me kolegët, eprorët, kontrollon funksionimin e makinerive dhe pajisjeve, higjienizon mjetet, pajisjet dhe makineritë, përgatit lëndët e para dhe ndihmëse, përcakton radhën e punës në repart, si dhe përzgjedh dhe përgatit mjetet e punës, kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për produktet që do të prodhojë, përgatit dhe reklamon produktet për shitje, plotëson dokumentet për marrjen e porosive dhe dorëzimin e produkteve të prodhuara. Punonjësi/ja për produkte brumi analizon, planifikon dhe koordinon punën me kolegë dhe eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së produkteve të brumit të prodhuara.	
3	A2-III-23	Teknologji e prodhimit të pijeve	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës i prodhimit të pijeve	8160.48	Prodhuesi/ja i/e pijeve alkoolike dhe joalkoolike merret me prodhimin e verës, rakisë, birrës, uthullës, pijeve alkoolike të forta dhe të ëmbla, lëngjeve të fruta - perimeve, pijeve freskuese, si dhe ambalazhimin dhe ruajtjen e tyre. Ai/Ajo siguron lëndën e parë dhe ndihmëse, bazën e nevojshme materiale, përzgjedh dhe përgatit makineritë, pajisjet dhe linjat për punë. Prodhuesi/ja i/e pijeve alkoolike dhe joalkoolike, kryen analiza të thjeshta për pranimin e lëndës së parë dhe ndihmëse, matje dhe peshime, përpunime mekanike dhe termike. Përpara prodhimit, ai/ajo lexon dhe interpreton planin e prodhimit, diskuton me kolegët, eprorët, kontrollon funksionimin e makinerive, pajisjeve dhe linjave, higjienizon mjetet, pajisjet, makineritë dhe linjat e prodhimit, përgatit lëndët e para dhe ndihmëse dhe përcakton radhën e punës në repart. Ai/Ajo kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për produktet që do të prodhojë, përgatit dhe reklamon produktet për shitje, plotëson dokumentet për marrjen e porosive, si dhe dorëzimin e produkteve të prodhuara. Prodhuesi/ja i/e pijeve alkoolike dhe joalkoolike planifikon dhe koordinon punën me kolegë dhe eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të higjienës personale dhe të ambientit të punës, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e sigurisë dhe cilësisë së produkteve të pijeve alkoolike dhe joalkoolike.	
4	A3-III-22	Teknologji e përpunimit të qumështit	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Prodhues të produkteve dhe nënprodukteve të qumështit	7515	Prodhuesi/ja i/e produkteve dhe nënprodukteve të qumështit merret me grumbullimin dhe pranimin e qumështit, prodhimin e qumështit për konsum, qumështit pluhur, qumështit UHT dhe të kondensuar, të kosit, kosit të ngrirë, gjizës, të gjalpit dhe kremrave, të djathërave të llojeve të ndryshme, si dhe ambalazhimin dhe ruajtjen e tyre. Ai/Ajo siguron lëndën e parë dhe ndihmëse, bazën e nevojshme materiale dhe përgatit makineritë, pajisjet dhe linjat për punë, duke zbatuar rregullat e ruajtjes dhe sigurisë ushqimore, si dhe të mbrojtjes së mjedisit. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme të përpunimit të qumështit, në baxho, si grumbullues i qumështit, apo edhe të vetëpunësohet. Prodhuesi/ja i/e produkteve dhe nënprodukteve të qumështit grumbullon qumështin, kryen analiza të thjeshta për pranimin e qumështit, matje dhe peshime, filtrime, përpunime termike (pasterizim, sterilizim, zierje, ftohje, avullim, kondensim), skremim, standardizim, baktofugim, homogjenizim, fermentim, inkubim, përpunimin e pastës së djathit, formime, presime, kriposje, stazhionim, parafinim, rrahje, shpëlarje, ambalazhime, ruajtje, sistemime, reklamime dhe promovime. Përpara prodhimit, ai/ajo lexon dhe interpreton planin e prodhimit, diskuton me kolegët, eprorët, kontrollon funksionimin e makinerive, pajisjeve dhe linjave, higjienizon mjetet, pajisjet, makineritë dhe linjat e prodhimit, përgatit lëndët e para dhe ndihmëse, përcakton radhën e punës në repart, si dhe përzgjedh dhe përgatit mjetet e punës. Ai/ajo kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për produktet që do të prodhojë, përgatit dhe reklamon produktet për shitje, plotëson dokumentet për marrjen e porosive, si dhe dorëzimin e produkteve të prodhuara. Prodhuesi/ja i/e produkteve dhe nënprodukteve të qumështit analizon, planifikon dhe koordinon punën me kolegë dhe eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e sigurisë dhe cilësisë së produkteve dhe nënprodukteve të qumështit.	
5	A4-III-18	Teknologji e përpunimit të mishit dhe peshkut	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kasapë, shitës peshku dhe përgatitës ushqimesh që lidhen me to	7511		Kasapi/ja, shitësi/ja i/e peshkut dhe përgatitësi/ja i/e ushqimeve që lidhen me to pastron, ther, rrjep, pret mishin dhe peshkun, si dhe përgatit artikuj të ngjashëm ushqimor, konservon mishin, peshkun ose ushqime të tjera që lidhen me to duke i tharë, kriposur, tymosur apo në mënyra të tjera. Ai/Ajo mund të punësohet në ferma, kompani shërbimesh e prodhimesh të këtyre artikujve apo të vetëpunësohet.
6	A5-III-18	Teknologji e përpunimit të fruta-perimeve	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Përpunues të frutave dhe perimeve	7516		Përpunuesi/ja i/e frutave dhe perimeve merret me përgatitjen, përpunimin ose konservimin e frutave, perimeve dhe ushqimeve të ngjashme në mënyra të ndryshme, përfshirë zierjen, tharjen, kriposjen ose ekstraktimin e lëngjeve ose vajit, për tregti dhe konsum. Ai/Ajo përgatit nënprodukte të perimeve, të frutave, prodhon pije alkoolike dhe jo-alkoolike etj. Ai/Ajo merret me përpunimin, ambalazhimin dhe ruajtjen dhe tregtimin e tyre. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme shërbimesh, prodhimesh ushqimore, në shoqëri tregtare që kanë reparte të shërbimit ushqimor dhe të vetëpunësohet.
7	A6-III-26	Teknologji e përpunimit të brumërave	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Bërës produktesh brumi	7513	Punonjësi/ja për prodhime mielli dhe produkte brumi merret me prodhimin e miellit, bukëve të llojeve të ndryshme, asortimenteve të kripura, të ëmbla, makaronave dhe ruajtjen e tyre. Ai/Ajo siguron bazën e nevojshme materiale dhe përgatit makineritë apo pajisjet për punë duke zbatuar rregullat e ruajtjes dhe sigurisë ushqimore. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme shërbimi ushqimore, në shoqëri tregtare që kanë reparte të shërbimit ushqimor apo edhe të vetëpunësohet. Punonjësi/ja për produkte brumi kryen matje dhe peshime, shtimin e lëndëve të para dhe ndihmëse në brumëgatuese, përzierje, nxjerrjen e brumit, prerje, presime, formime, hapje të brumit, fermentime, lyerje dhe dekorime, tharje, pjekje, ambalazhime, sistemime, reklamime dhe promovime. Përpara prodhimit, ai/ajo lexon dhe interpreton recetën, diskuton me kolegët, eprorët, kontrollon funksionimin e makinerive dhe pajisjeve, higjienizon mjetet, pajisjet dhe makineritë, përgatit lëndët e para dhe ndihmëse, respekton radhën e punës në repart, si dhe përzgjedh dhe përgatit mjetet e punës, kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për produktet që do të prodhojë, përgatit dhe reklamon produktet për shitje, plotëson dokumentet për marrjen e porosive dhe dorëzimin e produkteve të prodhuara. Punonjësi/ja për produkte brumi analizon, planifikon dhe koordinon punën me kolegë dhe eprorë duke komunikuar në mënyrë etike e profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë, të higjienës vetjake, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore për produktet e brumit të prodhuara.	
8	A-IV-23	Teknologji ushqimore	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Përgjegjës prodhimi për përpunimin të produkteve ushqimore	3122.12	Tekniku/ja i/e teknologjisë ushqimore analizon, planifikon dhe organizon punën lidhur me radhën e punës, kohën e punës, lëndën e parë dhe ndihmëse, bazën e nevojshme materiale, makineritë, pajisjet dhe linjat për punë, duke zbatuar rregullat e higjienës dhe sigurisë ushqimore. Tekniku/ja i/e teknologjisë ushqimore mbikëqyr procesin e higjienizimit, zbatimin e kartës teknologjike dhe zbatimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore. Ai/Ajo kryen analiza/testime të thjeshta për lëndën e parë, gjatë prodhimit në proces, për produktin e gatshëm, për ambalazhin, si dhe interpreton rezultatet e analizave dhe testimeve të kryera. Tekniku/ja i/e teknologjisë ushqimore diskuton me kolegët, eprorët, specialistët e tjerë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit.	
9	A1-V-26	Kontroll laboratorik i ushqimit	Program pas i mesëm 1-vjeçar studimi	Laborant të produkteve ushqimore	3119.03	Laboranti/ja i/e produkteve ushqimore kryen planifikimin dhe organizimin e punës. Ai/Ajo harton planin ditor/javor të analizave laboratorike, planifikon dhe përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, si dhe pastron dhe sistemon vendin dhe mjetet/pajisjet e punës. Laboranti/ja i/e produkteve ushqimore kryen pranimin e mostrës, duke verifikuar dokumentacionin shoqërues dhe gjendjen fizike të mostrës, si dhe duke koduar dhe regjistruar mostrën. Ai/Ajo kryen trajtimin e mostrës duke e përgatitur atë sipas metodave të përcaktuara teknike laboratorike dhe duke respektuar rregullat e higjienës dhe sigurisë ushqimore. Laboranti/ja i/e produkteve ushqimore kryen analizimin e mostrës me procedura fiziko - kimike, mikrobiologjike, organo - shqisore dhe instrumentale, sipas kërkesës së produktit. Laboranti/ja i/e produkteve ushqimore kryen detyra administrative dhe financiare, dokumenton punën e kryer dhe raporton tek eprorët. Ai/Ajo bashkëpunon me kolegët, eprorët dhe specialistë të tjerë duke komunikuar në mënyrë etike e profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. Ai/Ajo respekton rregullat e sigurisë teknike, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të punës. Laboranti/ja i/e produkteve ushqimore siguron cilësinë e proceseve dhe rezultateve laboratorike duke zbatuar standardet, protokollet dhe procedurat e kontrollit të cilësisë.	
10	B-II-25	Ndërtim	Program 2-vjeçar studimi për punonjës gjysëm i kualifikuar (ndihmës)	Punëtorë të ndërtimit të banesave	9313	Ndihmësi/ja në ndërtim ndihmon në punime hekurkthimi, karpenterie dhe betonimi, kryen punime ndihmëse në muratim dhe suvatime, ndihmon në realizmin e nënshtresave dhe shtresave niveluese dhe shtresave izoluese. Ai/Ajo kryen punime ndihmëse në punime gipsi, patinime dhe lyerje, në izolime, në shtrim dhe veshje me pllaka, në punime fasadash, në punime ndërtimi çatie dhe tarrace, si dhe në ndërtime rugësh. Ndihmësi/ja në ndërtim koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, si dhe të ruajtjes së mjedisit.	
11	B1-III-21	Muratim dhe suvatim	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Muratorë dhe Suvatues	7112 dhe 7123	Muratori/ja dhe suvatuesi/ja analizon, planifikon dhe organizon punën. Ai/Ajo kryen matje dhe shënime duke përdorur instrumentet dhe pajisjet përkatëse. Muratori/ja ndërton dhe riparon mure të ndryshme tulle e guri, ndërton mure dekorative duke përdorur teknika dhe pajisje të ndryshme, ndërsa suvatuesi/ja suvaton dhe riparon lloje të ndryshme muresh të brendshme dhe të jashtme sipas teknikave të duhura të përcaktuara në projekt duke përdorur pajisjet përkatëse. Muratori/ja dhe suvatuesi/ja diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton regullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe përditësuar me teknologjitë e reja për muratim dhe suvatim.	

12	B2-III-21	Shtrim pllakash dhe veshje muresh	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to	7122	Shtruesi/ja i/e dyshemesë analizon, planifikon dhe organizon punën, përgatit vendin e punës, kryen nivelim të sipërfaqeve, kryen izolimin e sipërfaqeve, shtron dysheme me materiale vinili (vinyl) dhe laminat, shtron dysheme me materiale druri, shtron sipërfaqe me linoleum, moket dhe tapet të gomuar, shtron dysheme teknike (e ngritur), si dhe mirëmban dhe riparon sipërfaqet e ndryshme. Ai/Ajo kryen matje dhe prerje duke përdorur instrumentet dhe pajisjet përkatëse. Shtruesi/ja i/e dyshemesë koordinon punën me grupet e tjera për instalimet e ndryshme të infrastrukturës në ndërtim, me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
13	B3-III-22	Karpentieri, hekurkthim dhe betonim	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Karpentier, betonues dhe të tjerë që lidhen me to	7115.02 dhe 7114	Hekurkthyesi/ja dhe betonuesi/ja analizon, planifikon, organizon punën dhe parapërgatit vendin e punës. Ai/Ajo kryen matje dhe shënime duke përdorur instrumentet ose pajisjet përkatëse. Hekurkthyesi/ja pret dhe kthen shufrat e hekurit, vendos dhe i fikson ato në struktura betonarme duke përdorur teknika, pajisje dhe makineri të ndryshme. Betonuesi/ja ndërton, monton dhe instalon struktura druri sipas teknikave të duhura të përcaktuara në projekt, duke përdorur pajisjet përkatëse me qëllim betonimin e elementeve të ndryshme betonarme. Hekurkthyesi/ja dhe betonuesi/ja diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja për punime hekuri dhe betoni.	
14	B4-III-22	Punime dhe riparim rrugësh	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Shtrues rrugësh	7113.22 dhe 7119.15	Punëtori/ja specialist/e për punime dhe riparim rrugësh planifikon dhe organizon punën dhe vendin e punës. Ai/Ajo kryen punime gërmimi për puseta, për kuneta, për themelet e mureve, në pjesët e deformuara të rrugës, kanalet, veprat e artit etj. duke përdorur mjete dhe makineri të ndryshme. Punëtori/ja për punime dhe riparim rrugësh realizon punime shtresash për ndërtimin e trupit të rrugës dhe punime për ndërtimin apo rikonstruksionin e veprave të artit. Ai/Ajo bën punime ndërtimi shtresash për korsitë e lëvizjes së mjeteve në rrugë, për trotuarin, punime asfaltimi, punime për infrastrukturën nëntokësore, sinjalistikën rrugore, gjelbërimin etj. Ai/Ajo kryen mirëmbajtjen dhe riparimin e shtresave rrugore, si dhe siguron cilësinë e punimeve në përfundimin të çdo procesi të kryer. Punëtori/ja për punime dhe riparim rrugësh diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja për punimet në rrugë.	
15	B5-III-20	Punime dekorative dhe bojatisje	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Bojaxhinj ndërtesash dhe të tjerë që lidhen me to	7131	Bojaxhiu/a merret me përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave për lyerje, përgatitjen e bojërave dhe materialeve që do të përdoren për lyerje, si dhe lyerjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të ndryshme, sipas projekteve dhe kërkesave të klientëve. Ai/Ajo mund të vendosë shtresa të materialeve mbrojtëse dhe lidhëse. Bojaxhiu/a kryen punime dekorative të ngjashme ose mbulon mure të brendshme dhe tavane të ndërtesave me letër, duke përdorur teknikat dhe materialet e duhura. Ai/Ajo komunikon dhe bashkëpunon me kolegë dhe eprorë në mënyrë etike dhe profesionale. Ai/Ajo jep dhe merr udhëzime për kryerjen e punimeve, zbaton teknikat dhe standardet sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, kryen llogaritje vëllimesh pune dhe kosto të materialeve për punimet e kryera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit, si dhe siguron cilësinë e shërbimeve të kryera.	
16	B6-III-16	Mirëmbajtje ndërtesash	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë mirëmbajtjeje për ndërtesa	7119.09		Punëtori/ja i/e ndërtimit, i pa klasifikuar diku tjetër, kryen punë të ndryshme në ndërtim, si punime të mirëmbajtjes së ndërtesave, të strukturave të ndryshme për zyra, shtëpi, apartamente, fabrika dhe ndërmarrje të ngjashme. Ai/Ajo kryen punime montimi apo çmontimi të strukturave metalike apo druri, punime duro-alumini, kryen shembje të ndërtesave. Ai/Ajo kryen operacionet e duhura në prodhimin e gëlqeres apo të prodhimeve të qeramikës. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të shërbimeve të ndërtimit apo të vetëpunësohet.
17	B-IV-23	Ndërtim	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Përgjegjës ndërtimi	3123	TeknikU/ja i/e mesëm/me i/e ndërtimit analizon, planifikon, organizon punën dhe kontribuon në realizimin dhe mbajtjen e dosjes teknike të zbatimit në kantier. Ai/Ajo ndjek zbatimin e projektit dhe kontrollon punimet e muratimit dhe suvatimit, për shtrim pllakash dhe veshje muresh, punimet dekorative dhe bojatisje, punimet në rrugë dhe trotuare, proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së punimeve etj. Ai/Ajo ndihmon në hartimin e grafikut të punimeve dhe kontrollon ngritjen e kantierit. TeknikU/ja i/e mesëm/me i/e ndërtimit kryen llogaritjet e kostove në kantier dhe raporton tek eprorët mbi realizimet e kryera. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e ndërtimit.	
18	B/1-IV-25	Ndërtim efiçient	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik i mesëm ndërtimi	3119.15	TeknikU/ja i/e mesëm/me i/e ndërtimit kryen planifikimin dhe organizimin e punimeve të ndërtimit, të punimeve teknologjike dhe të punimeve të montimit në kantier. Ai/Ajo mban dokumentacionin teknik të zbatimit në kantier, drejton punimet për ndërtimin e strukturës së objektit, sipas udhëzimeve të drejtorit të kantierit, drejton punimet për ndërtimin e shtresave dhe dyshemeve dhe punimet e rifiniturave në ndërtim. TeknikU/ja i/e mesëm/me i/e ndërtimit monitoron punimet e instalimeve elektrike, hidraulike, instalimeve mekanike, teknologjike dhe të montimit në bashkëpunim me specialistët e fushave përkatëse, drejton punime të infrastrukturës rrugore dhe sistemet e kanalizimit dhe shkarkimit, kontrollon cilësinë e punimeve në ndërtim, kryen llogaritjet e kostove në kantier, si dhe raporton tek eprorët mbi realizimet e kryera. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e ndërtimit.	
19	B1-V-25	Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme	Program, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Dekorator dhe dizenjues të ambienteve të brendshme	3432	Dizenjuesi/ja dhe dekoratori/ja i/e ambienteve të brendshme zhvillon dhe krijon ide pamore, harton projekt-idenë dhe harton dizenjime estetike, funksionale për hapësirat e brendshme në ndërtesat e banimit, komerciale, kulturore, institucionale dhe industriale komerciale, publike dhe individuale për të krijuar një mjedis të përshtatur, sipas qëllimit të përdorimit, duke marrë parasysh faktorët që përmirësojnë jetesën. Ai/Ajo kryen planifikimin dhe organizimin e punës, parapërgatitjen për fillimin e projekt-idesë, konsultohet me klientin dhe kolegë, si dhe përdor metoda të kërkimit, të përpunimit dhe sintetizimit të informacionit, software dhe programe të ndryshme. Dizenjuesi/ja dhe dekoratori/ja i/e ambienteve të brendshme realizon projekt-zbatimin, kryen mbikëqyrjen e punimeve për dekorimin e ambienteve të brendshme dhe dorëzon detyrën e marrë. Ai/Ajo koordinon, përzgjedh dekoret dhe merr pjesë në ndërtimin e tyre duke bërë dhe vlerësimin e kostove të shpenzimit dhe materialeve të duhura. Dizenjuesi/ja dhe dekoratori/ja i/e ambienteve të brendshme kryen detyra administrative dhe tregtare, interpreton dhe plotëson dokumentacionin e duhur teknik. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët, eprorët dhe klientët duke zbatuar parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. Ai/Ajo gjatë kryerjes së punimeve, respekton me përpikëri rregullat e sigurisë në punë, respekton standardet e sigurisë, manualet përkatëse të pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe legjislacionin në fuqi, për të garantuar cilësinë e shërbimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologji të reja.	
20	C-II-20	Përpunim druri	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtorë të përpunimit të drurit	7521	Ndihmësi/ja në përpunimin e drurit përgatit vendin e punës dhe makineritë, ndihmon punëtorin e kualifikuar (punëtorët) gjatë procesit të punës në sektorin e makinerive të ndryshme, në montimin e objekteve prej druri, në procesin e stukimit, pastrimit, lyerjes dhe lustrimit, kryen punime ndihmëse në tharjen dhe trajtimin e lëndës drusore, si dhe në ambalazhimin dhe magazinimin e tyre. Ai/Ajo kryhen transportin dhe sistemimin e materialit, furnizimin e vendit të punës me materiale, pastrimin e makinerive, pastrimin e vendit të punës, përdor makineritë apo pajisjet e punës nën mbikëqyrjen dhe instruksionin e personit përgjegjës. Ndihmësi/ja në përpunimin e drurit komunikon me kolegë dhe me eprorë në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
21	C1- III-22	Mobilieri dhe tapiceri	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm	7522	Mobilieri/ja bën përpunimin e materialit drunor, si dhe të prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri për prodhimin e dyerve, dritareve, grilave, shkallëve prej druri, kapriatave të çative, dyshemeve të shtëpive, mobilieve të ndryshme për ambiente të brendshme dhe të jashtme, prodhimeve artistike, prodhimin e mobilieve me tapiceri etj. Mobilieri/ja organizon vendin e punës, përzgjedh veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura, si dhe parapërgatitet për realizimin e objektit prej druri. Ai/Ajo përgatit vendin e punës, makineritë dhe pajisjet e duhura sipas proceseve të punës, kryen punime me vegla dore dhe mjete të mekanizuara të dorës, punime në makineri, montime paraprake etj. Mobilieri/ja kryen punime finisimi, riparime të mundshme, si dhe procese përfundimtare. Ai/Ajo realizon punime të mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës, interpreton dhe plotëson dokumentacionin teknik për shërbimet e kryera duke zbatuar standardet e profesionit. Ai/Ajo gjatë kryerjes së punimeve, zbaton dhe respekton, me përpikmëri, rregullat e sigurisë në përdorimin e makinerive, pajisjeve dhe materialeve, legjislacionin e fushës në fuqi, garanton cilësinë për shërbimet e kryera, plotëson dokumentacionin financiar, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë së shëndetit në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Mobilieri/ja diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e mobilierisë.	
22	C2- III-23	Prodhime druri gjysmë të gatshme	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës për prodhim materialesh me bazë druri	7521.01	Punonjësi/ja për prodhim materialesh me bazë druri bën organizimin e punës duke planifikuar dhe përzgjedhur lëndën e parë për përpunim, lëndët ndihmëse, mjetet dhe makineritë për punë etj. Ai/Ajo kryen punime në depozitën e lëndës së parë, bën përpunimin mekanik të drurit, si dhe kryen procese pune me kimikate. Ai/Ajo formon pllakën gjysmë të gatshme të lëndës drunore, realizon procese ngjitje dhe presimi, procese finisimi dhe magazinimi të pllakave me bazë druri. Punonjësi/ja për prodhim materialesh me bazë druri diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe produkteve të prodhuara, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e produkteve. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja për fushën e prodhimit të materialeve me bazë druri.	
23	C3-III-26	Mobilieri dhe tapiceri	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Mobilier dhe Tapicier	7522.06 dhe 7522.28	Mobilieri/ja - tapicieri/ja kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke marrë informacion dhe analizuar kërkesat e klientit, duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, duke siguruar ndriçimin, ventilimin dhe pastërtinë e ambientit të punës, bashkëpunon me të tjerët, si dhe raporton për punën e kryer. Mobilieri/ja - tapicieri/ja parapërgatitet për prodhimin e produktit, kryen operacione me makineri, vegla dore dhe mjete elektrike të dorës, kryen lyerjen e detaleve/elementëve, kryen montimin e detaleve/elementëve, kryen punime tapicerie me bazë druri, kryen riparime të mundshme restauruese dhe kryen procese përfundimtare. Mobilieri/ja - tapicieri/ja kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Mobilieri/ja - tapicieri/ja ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	

24	C-IV-24	Përpunim druri	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	3122.02	Përgjegjësi/ja i/e prodhimit për përpunimin e drurit analizon, planifikon dhe organizon punën duke zbërthyer planin e prodhimit ose projektin për të planifikuar dhe siguruar burimet e nevojshme njerëzore, mjetet, makineritë, pajisjet dhe instrumentat, materialet e nevojshme, si dhe për të përcaktuar radhën dhe kohën e punës sipas proceseve të punës. Përgjegjësi/ja i/e prodhimit për përpunimin e drurit mbikëqyr procesin e sigurimit dhe ruajtjes së lëndës së parë dhe ndihmëse, mbikëqyr procesin e prodhimit, mbikëqyr mirëmbajtjen e makinerive dhe instrumentave prerës, si dhe kryen procesin e tharjes së lëndës drunore. Ai/Ajo në kuadër të kontrollit të cilësisë së punimeve, kontrollon cilësinë dhe parametrat e lëndës së parë, përmasat e produktit të prodhuar, cilësinë e lustrimit dhe lyerjes, cilësinë e imprenjimit, cilësinë e punimit të makinerive, merr masa për të zgjidhur dhe shmangur defektet e prodhimit, si dhe kontrollon paketimin, magazinimin, marketimin dhe ambalazhimin. Përgjegjësi/ja i/e prodhimit për përpunimin e drurit kryen detyra administrative dhe tregtare, si dhe raporton tek eprorët mbi realizimet apo problematikat gjatë punës. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Përgjegjësi/ja i/e prodhimit për përpunimin e drurit zbaton rregullat e sigurisë në punë, bashkëpunon me ekspertët për hartimin e raporteve të vlerësimit të riskut të aksidenteve në punë, zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve/shërbimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin e tij/saj profesional duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e përpunimit të drurit, organizon trajnimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve, si dhe punon për përmirësimin e procesit të prodhimit.	
25	D-II-22	Tekstil-Konfeksione	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtorë të prodhimit të tekstileve, lëkurës dhe gëzofit	815	Punonjësi/ja i/e tekstilit, lëkurës dhe materialeve të tjera të ngjashme me to, kryen matje të ndryshme në trupin e njeriut dhe në objekte të tjera për të cilat do të realizojë produktin, ndërton skica të produktit, ndërton kallëpe të thjeshta për to, realizon prerje të thjeshta dhe qepje të elementeve të veçantë, kryen procese përfundimtare, hekurosjen dhe frazelimin, riparime të thjeshta si dhe vlerëson fibrat. Punonjësi/ja i/e tekstilit, lëkurës dhe materialeve të tjera të ngjashme me to përzgjedh dhe përgatit veglat, pajisjet dhe makineritë e punës për punimet që do të kryejë, punon në grup duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.	
26	D1-III-23	Rrobaqepësi	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Rrobaqepës	7531	Rrobaqepësi/ja planifikon dhe organizon vendin e punës, bashkëpunon me klientin për realizimin e veshjes, kryen matje të ndryshme në trupin e njeriut dhe në objekte të tjera për të cilat do të realizojë produktin, ndërton skica të produktit, ndërton kallëpet për modelin e zgjedhur dhe pret elementët e veshjes në tekstil. Ai/Ajo kryen provën e qëndrimit në trup të veshjes, realizon qepjen e veshjes, kryen procese përfundimtare të veshjes, realizon punime dekorative, aksesorë, riparime dhe modifikime. Rrobaqepësi/ja përzgjedh dhe përgatit veglat, pajisjet dhe makineritë e punës për punimet që do të kryejë, kryen detyra administrative dhe tregtare, punon në grup duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.	
27	C2-III-20	Tekstil	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë të tjerë të industrisë tekstile dhe përpunimit të lëkurës jo të klasifikuar diku tjetër	8159		Punëtorët e industrisë tekstile dhe përpunimit të lëkurës jo të klasifikuar diku tjetër kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që formojnë dhe bëjnë kapele nga tekstile leshi ose nga lëkura; b) Drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që bëjnë artikuj të ndryshëm siç janë shiritat dhe aksesorët; c) Drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që bëjnë palosjen e veshjeve sipas gjatësisë së tyre; d) Drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që fryjnë fijet, spangon ose fillin në përgatitjen e topave për tek ngarkesa ose përpunim të mëtejshëm; e) Drejtojnë dhe monitorojnë makineritë për të matur masën e copave të lëkurës; f) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit dhe g) Zbatojnë rregullat etikës në vendin e punës.
28	D3-III-24	Modelim	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Modelistë, prestarë dhe punonjës të tjerë të ngjashëm	7532	Modelisti/ja planifikon dhe organizon vendin e punës, duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore të nevojshme, mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme, si dhe duke përcaktuar radhën e punës. Ai/Ajo kryen marrjen e masave dhe nxjerrjen e tyre nga tabelat e përmasave, përgatit kallëpet, krijon prototipin, kryen përshtatjen e veshjes/aksesorit me trupin, zhvillon kallëpet në masa të tjera dhe konfeksionon produktin (veshjet ose aksesorët). Modelisti/ja kryen kontrollin e cilësisë lidhur me saktësinë e masave të marra, kallëpeve bazë, transferimin e kallëpeve nga letra në tekstil dhe anasjelltas, vendosjen e kallëpeve në material, prerjen e materialeve, qepjen e elementëve dhe realizimin e produktit përfundimtar. Modelisti/ja kryen detyra administrative dhe tregtare, punon në grup duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.	
29	D4-III-16	Prodhime lëkure (Galanteri)	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Prodhues të këpucëve dhe galanteria	7537		Prodhuesi/ja i/e këpucëve dhe galanterisë punon dhe prodhon me porosi këpucë standarde ose ortopedike dhe artikuj të tjerë lëkure natyrore ose sintetike si valixhe, çanta, rripa, pajimet për kafshët etj. (me përjashtim veshje lëkure, kapele dhe dorashka)apo merr pjesë në prodhimin e këpucëve apo artikujve të ngjashëm. Ai/Ajo riparon, dekoron, zbukuron, përforcon apo përfundon këta artikuj. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani shërbimesh apo prodhimesh të artikujve prej lëkure apo të vetëpunësohet.
30	D5-III-26	Rrobaqepësi	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Rrobaqepës	7531	Rrobaqepësi/ja planifikon dhe organizon punën, duke analizuar realizimin e produktit, duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet, pajisjet e punës dhe aksesorët, duke planifikuar kohën dhe radhën e punës, duke kontrolluar funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe duke pastruar dhe sistemuar vendin e punës. Robaqepësi/ja vizaton modele të thjeshta, ndërton kallëpet për modelin e zgjedhur dhe pret elementët e veshjes në tekstil. Ai/Ajo kryen provën e qëndrimit në trup të veshjes, realizon qepjen e veshjes, kryen procese përfundimtare të veshjes, realizon punime dekorative, si dhe kryen riparime dhe modifikime në veshjet ekzistuese. Rrobaqepësi/ja kryen një sërë detyrash administrative dhe tregtare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Rrobaqepësi/ja ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
31	D-IV-25	Tekstil-konfeksione	Program 1-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e tekstileve	3122.11	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në tekstil - konfeksion analizon, planifikon dhe organizon punën duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, si dhe duke përcaktuar proceset, radhën dhe kohën e punës. Ai/ajo mbikëqyr proceset e prodhimit të tekstilit, proceset e modelimit, proceset e robaqepsisë dhe proceset e galanterisë/këpucëve. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në tekstil - konfeksion kryen detyra administraive dhe tregtare, bashkëpunon me specialistë të tjerë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së produkteve të prodhuara, proceseve të kryera dhe materialeve të përdorura.	
32	D1-V-25	Dizenjim mode	Program, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Dizenjues të produkteve dhe veshjeve	2163	Dizenjuesi/ja i/e produkteve dhe veshjeve kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke planifikuar koleksionin/veshjen/produktin, burimet njerëzore të nevojshme, mjetet, materialet dhe aksesorët, radhën dhe kohën e punës. Ai/Ajo ndan detyrat në ekip dhe bashkëpunon ngushtësisht me modelistin, robaqepësin ose specialistë të tjerë sipas proceseve të punës. Dizenjuesi/ja i/e produkteve dhe veshjeve hulumton për krijimin e konceptit, krijon konceptin, skicon modelin dhe zhvillon modelin. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e komunikimit etik dhe profesional me eprorët, bashkëpunëtorët dhe klientët, zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, fetare etj, si dhe zbaton rregullat e sigurimit teknik, dhe mbrojtjes së mjedisit.	
33	E-II-21	Elektroteknikë	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Instalues dhe riparues të pajisjeve dhe rrjetit elektrik	741	Ndihmësi/ja në elektroteknikë përgatit infrastrukturën për instalime elektrike dhe elektronike, kryen montime dhe instalime të thjeshta elektrike dhe elektronike, kryen riparime të pajisjeve të thjeshta elektrike dhe elektronike, kryen mirëmbajtje të thjeshta elektrike dhe mirëmbajtje të pajisjeve të thjeshta elektronike. Ai/Ajo punon nën mbikëqyrje dhe zbaton udhëzimet e specialistëve të fushës. Ai/Ajo mund të punojë vetëm apo me një grup pune në një kompani për kryerjen e instalimeve dhe riparimeve të pajisjeve dhe rrjetit elektrik, duke iu përmbajtur afateve kohore të projektit, buxhetit të caktuar, politikave dhe rregulloreve të kompanisë. Ndihmësi/ja në elektroteknikë organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
34	E1-III-21	Instalime elektrike civile dhe industriale	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Elektricistë në banesa dhe të tjerë të ngjashëm	7411	Elektricisti/ja instalon sistemet e ndriçimit dhe të fuqisë në objekte civile dhe industriale, sistemet e sinjalizimeve, sistemet e tokëzimit mbrojtës dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike në objekte civile dhe industriale. Ai/Ajo instalon sistemet e matjes së energjisë, me dhe pa transformatorë rryme, burimet rezervë të energjisë, sistemet e automatizuara dhe burimet e rinovueshme të energjisë në objekte civile dhe industriale. Ai/Ajo diagnostikon problematikat, kryen mirëmbajtje dhe riparime të impiantit elektrik në objekte civile dhe industriale, kryen dokumentimin dhe raportimet për punën e kryer. Për realizimin e funksioneve të tij/saj, elektricisti/ja, në çdo rast ndjek procedura rigoroze të paraparcaktuara në udhëzues, manuale teknike apo dokumente të tjera të përgatitur nga specialist të një niveli më të lartë. Elektricisti/ja analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
35	E2-III-21	Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe tensionit të lartë	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Instalues dhe riparues të rrjetit elektrik	7413	Instaluesi/ja dhe riparuesi/ja i/e rrjetit elektrik kryen punime në linjat ajrore dhe kabllore të TU dhe TL, monton terminalet dhe xhuntot e kabllove të TU dhe TL, instalon pajisjet primare dhe sekondare në nënstacione elektrike, monton sallat e baterive dhe radrizatorët, monton panelet e komandimit dhe mbrojtjes rele, instalon sistemet e kontrollit dhe monitorimit. Ai/Ajo kryen kontrolle, mirëmbajtje dhe riparime të linjës ajrore apo nëntokësore të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, të transformatorëve dhe pajisjeve të tjera të lidhura me to. Përpara instalimeve, ai/ajo lexon dhe interpreton projektin, diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët dhe sugjeron ndryshime të mundshme, përgatit bazën materiale për punën që do të kryejë, si dhe përzgjedh veglat dhe pajisjet e punës. Ai/Ajo kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, përgatit dhe plotëson dokumentet për punimet e kryera. Instaluesi/ja dhe riparuesi/ja i/e rrjetit elektrik analizon, planifikon dhe organizon punën, përgatit vendin e punës, planifikon dhe koordinon punën me grupet e tjera duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale me kolegë dhe me eprorë, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
36	E3-III-23	Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Riparues pajisjesh elektro-shtëpiake dhe të tjera	7414	Riparuesi/ja i/e pajisjeve elektroshtëpiake kryen matje dhe kontrolle për identifikimin e defektit/parregullsisë duke përdorur mjete, pajisje, instrumente dhe metodat përkatëse për diagnostikimin e defekteve. Ai/Ajo kryen montime/çmontime, riparime ose zëvendësime në pajisje, si dhe kryen mirëmbajtjen e pjesëve të lëvizshme të pajisjeve elektroshtëpiake. Riparuesi/ja i/e pajisjeve elektroshtëpiake lexon dhe interpreton manualet, diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët, siguron dhe përgatit bazën materiale për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes që do të kryejë, si dhe përzgjedh veglat dhe pajisjet e punës. Ai/Ajo kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, përgatit dhe plotëson dokumentet për punimet e kryera. Riparuesi/ja i/e pajisjeve elektroshtëpiake analizon, planifikon dhe organizon punën, përgatit vendin e punës, planifikon dhe koordinon duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale me kolegë dhe me eprorë, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	

37	E4-III-22	Elektromekanikë	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Elektromekanik	7412	Elektromekaniku/ja kryen montime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve në reparte industriale, instalon panelet elektrike të furnizimit dhe komandimit të makinerive dhe pajisjeve, monton sistemet ndihmëse për funksionimin e makinerive dhe pajisjeve, si dhe monton dhe instalon pajisjet në kabinën elektrike. Ai/Ajo kryen kontrolle, mirëmbajtje dhe riparime të makinerive dhe sistemeve ndihmesë të lidhura me to. Përpara instalimeve, ai/ajo lexon dhe interpreton projektin, diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët dhe sugjeron ndryshime të mundshme, përgatit bazën materiale për punën që do të kryejë, si dhe përzgjedh veglat dhe pajisjet e punës. Ai/Ajo kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për punimet e kryera. Elektromekaniku/ja analizon, planifikon dhe organizon punën, përgatit vendin e punës, planifikon dhe koordinon punën me grupet e tjera duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale me kolegë dhe me eprorë, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
38	E9-III-26	Instalime elektrike civile dhe industriale	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Elektricist në banesa dhe të tjerë të ngjashëm	7411	Elektricisti/ja në banesa dhe të tjerë të ngjashëm kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke interpretuar projektin, duke analizuar kushtet teknike të objektit/terrenit, duke planifikuar proceset e punës, si dhe duke përcaktuar radhën dhe kohën e punës. Ai/Ajo planifikon dhe përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, siguron materialet, kryen pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, bashkëpunon me të tjerët, si dhe raporton për punën e kryer. Elektricisti/ja në banesa dhe të tjerë të ngjashëm kryen procese paraprake në terren, kryen mirëmbajtje dhe riparime të impiantit elektrik, si dhe realizon energjizimin e sistemit dhe pajisjeve. Ai/Ajo instalon sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemin e tokëzimit mbrojtës, sistemin mbrojtës nga shkarkimet atmosferike, si dhe sistemet e rrymave të dobëta dhe sinjaleve. Elektricisti/ja në banesa dhe të tjerë të ngjashëm kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Elektricisti/ja në banesa dhe të tjerë të ngjashëm ngre nivelin e tij/saj profesional duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
39	E10-III-26	Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Instalues dhe mirëmbajtës i linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë	7413	Instaluesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke analizuar projektet, skemat elektrike dhe dokumentacionin teknik, duke përcaktuar prioritetet e ndërhyrjeve, radhën e punës, kohën e punës dhe duke planifikuar ndërprerjet e energjisë elektrike. Ai/Ajo planifikon dhe përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, siguroheт për pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, bashkëpunon me të tjerët, si dhe raporton për punën e kryer. Instaluesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë instalon pajisjet e tensionit të ulët dhe të mesëm, pajisjet e tensionit të lartë në nënstacionin elektrik dhe pajisjet e linjave të tensionit të lartë. Ai/Ajo instalon pajisjet e kabinës elektrike, sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe kryen mirëmbajtjen e rrjetit të T.U.-T.M.-T.L.. Instaluesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Instaluesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
40	E5-IV-24	Teknologji automatizimi	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik/operator i linjave të automatizuara	3139.02	Tekniku/ja i/e kontrollit të linjave të automatizuara është përgjegjës për instalimin, testimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve dhe pajisjeve të automatizuara të kontrollit. Ai/Ajo diagnostikon dhe zgjidh problemet, si dhe identifikon zgjidhjet për të siguruar performancën dhe funksionimin optimal të sistemeve. Tekniku/ja i/e kontrollit të linjave të automatizuara merret me instalimin dhe konfigurimin e sistemeve të kontrollit, testimin dhe kalibrimin e sistemeve, kryerjen e mirëmbajtjes parandaluese, riparimin dhe zëvendësimin e komponentëve të sistemit sipas nevojës. Ai/Ajo është përgjegjës për përditësimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të automatizimit për të rritur produktivitetin dhe për të zvogëluar kohën e ndërprerjes. Tekniku/ja i/e kontrollit të linjave të automatizuara komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Tekniku/ja i/e kontrollit të linjave të automatizuara ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja.	
41	E6-IV-24	Riparime të pajisjeve elektronike	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Mekanik dhe mirëmbajtës i pajisjeve elektronike	7421	Tekniku/ja i/e riparimit të pajisjeve elektronike është përgjegjës/e për riparimin e produkteve elektronike shtëpiake ose të biznesit, të tilla si: televizorët, kompjuterët, printerat, fotokopjet etj. Ai/Ajo punon për të instaluar, konfiguruar, testuar, kalibruar, identifikuar dhe zgjidhur mosfunksionimet e pajisjeve, mirëmbajtur dhe riparuar ato, si dhe në prodhimin dhe vendosjen e pajisjeve elektronike të automatizimit në industri duke përdorur pajisje të ndryshme matëse dhe diagnostikuese. Tekniku/ja i/e riparimit të pajisjeve elektronike duhet të lexojë skema, vizatime skematike dhe udhëzime inxhinierike për të kryer shërbimet e duhura. Gjithashtu, ai/ajo shkruan raporte dhe regjistron të dhëna për teknikat e testimit, pajisjet laboratorike dhe specifikimet përkatëse. Tekniku/ja i/e riparimit të pajisjeve elektronike analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në ndërveprimin/komunikimin me të tjerët. Tekniku/ja i/e riparimit të pajisjeve elektronike zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
42	E7-IV-24	Telekomunikacion	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik telekomunikacioni	7422.17	Tekniku/ja i/e telekomunikacionit kryen montimin, instalimin, riparimin ose mirëmbajtjen e rrjetave dhe pajisjeve të telekomunikacionit, si pajisjeve të transmetimit të të dhënave, antenave, kabllove, sinjaleve radio, burimeve të ushqimit etj. Ai/Ajo diagnostikon problemet në komponentë teknike të rrjeteve të telekomunikacionit, bën konfigurime të thjeshta të pajisjeve dhe kryen dokumentimin teknik të punës. Ai/Ajo përzgjedh dhe kryen porosinë paraprake për pajisje dhe pjesë këmbimi sipas kërkesave teknike të projektit apo pjesëve me defekt të sistemeve të telekomunikacioneve, mban lidhje me klientët përkatës dhe ndjek kërkesat për zgjidhjen e problematikave të caktuara në lidhje me sistemet. Për realizimin e funksioneve të tij/saj, ai/ajo, në çdo rast ndjek procedura rigoroze të parapërcaktuar në udhëzuesit apo manualet teknike apo nga specialistë të një niveli më të lartë. Tekniku/ja i/e telekomunikacionit analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
43	E8-IV-21	Mekatronikë	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknikë të kontrollit të linjave të automatizuara të paklasifikuar diku tjetër	3139	Tekniku/ja mekatronik/e kryen montimin fizik të sistemeve dhe makinerive të automatizuara, instalime dhe konfigurimin e tyre, ndihmon apo realizon komisionimin e pajisjeve apo sistemeve të automatizuara mbështetur në manualet përkatëse, si dhe kryen riparimin apo mirëmbajtjen e tyre. Ai/Ajo përdor sistemet mekatronike, diagnostikon problematikat, realizon riparime të thjeshta të sistemeve të automatizuara, kryen dokumentimin e punës dhe realizon raportimet për punën e kryer. Për realizimin e funksioneve të tij/saj ai/ajo, në çdo rast ndjek procedura rigoroze të parapërcaktuar në udhëzuesit apo manualet teknike apo nga specialistë të një niveli më të lartë. Tekniku/ja mekatronik/e analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
44	E-IV-25	Elektroteknikë	Program 1-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknikë të inxhinierisë elektrike	3113	Tekniku/ja elektrik/e kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke planifikuar proceset e punës, burimet njerëzore të nevojshme, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës. Ai/Ajo ndan detyrat në ekip dhe mbikëqyr përgatitjen, sistemimin dhe pastrimin e vendit të punës, si dhe mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës. Tekniku/ja elektrik/e ndjek zbatimin e projekteve elektrike duke kontrolluar instalimet elektrike civile dhe industriale, mbikëqyr instalimet e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë, si dhe kontrollon integrimin e sistemeve elektromekanike. Ai/Ajo ndjek instalimin e sistemeve për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike, mbikëqyr procesin e mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve dhe pajisjeve, kryen matje të parametrave elektrikë dhe mekanikë, si dhe kontrollon cilësinë e punimeve. Tekniku/ja elektrik/e koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
45	E1-V- 24	Energji e rinovueshme	Programe, pas të mesme 1-vjeçare studimi	Teknik elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	Tekniku/ja elektrik i/e energjisë së rinovueshme kryen planifikimin, organizimin dhe dokumentimin e punës. Ai/Ajo monton dhe instalon impiantet elektrike dhe mekanike në sistemet fotovoltaike dhe të erës (eolike), konfiguron dhe programon pajisjet e kontrollit në sistemet fotovoltaike dhe të erës (eolike). Tekniku/ja kryen testimin dhe verifikimin e impiantit fotovoltaik dhe të erës për performancën dhe mbrojtjen e sistemit, kryen monitorimin dhe shfrytëzimin e impianteve, si dhe shërbime mirëmbajtje dhe riparime të kërkuara në sistemet fotovoltaike dhe të erës. Tekniku/ja elektrik i/e energjisë së rinovueshme diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton regullat e sigurisë në punë, regullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për fushën përkatëse. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
46	F-II-22	Mekanikë	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Farkëtar, prodhues të veglave dhe punëtor të tjerë të ngjashëm	722	Ndihmësi/ja mekanik/e kryen punime të thjeshta axhusterie, punime të thjeshta saldimi, prerje dhe ngjitjeje, matje, shënjime, prerje, filetime, lakime, bashkime dhe punime të realizimit të konstruksioneve metalike të thjeshta dhe me materiale polimere duke përdorur instrumentet, veglat dhe pajisjet e duhura. Ai/Ajo kryen punime të thjeshta në makinat metalpunuese, përgatit dhe monton konstruksione të thjeshta metalike dhe me materiale polimere, si dhe kryen mirëmbajtje dhe punime të thjeshta të çmontimit dhe montimit të nyjeve, mekanizmave dhe agregateve në makinat të thjeshta industriale. Përpara fillimit të punimeve ai/ajo interpreton vizatimet apo skicat e dhëna dhe dokumentacion teknik, si dhe përzgjedh dhe përgatit bazën materiale, pajisjet e punës, instrumentet apo makineritë e duhura sipas proceseve të punës të përcaktuara nga tekniku përkatës. Ndihmësi/ja mekanik/e, nën mbikëqyrjen e specialistëve përkatës bashkëpunon me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
47	F1-III-23	Makina metalpunuese	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë dhe montues të makinerive metal punuese	7223	Punëtori/ja i/e makinerive metal punuese planifikon dhe organizon punën dhe vendin e punës, si dhe analizon vizatimet për realizimin e produktit të prodhimit sipas specifikimeve teknike. Ai/Ajo kryen punime në makineritë metal punuese, pasi ka zgjedhur materialin e nevojshëm për përpunim mekanik, makinerinë e përshtatshme (torno, frezë, stokatriçe, limatriçe, makina shpimi etj.) dhe pasi ka përcaktuar dhe programuar regjimet e makinës. Punëtori/ja i/e makinerive metal punuese bën matje gjatë procesit të punës dhe monitoron makinën për të rregulluar regjimin, për të rregulluar temperaturën dhe identifikuar problemet. Ai/Ajo kontrollon produktin për të siguruar përputhshmërinë me specifikimet teknike, eliminon defektet e mundshme, dokumenton prodhimin, bën dorëzimin e tij dhe kryen mirëmbajtjen e makinerive. Punëtori/ja i/e makinerive metal punuese diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton regullat e sigurisë në punë, regullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja për punimet në makineritë metal punuese.	
48	F2-III-23	Konstruksione metalike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	7214	Përgatitësi/ja i/e konstruksioneve metalike kryen zbërthimin e projektit dhe skicimeve të ndryshme, kryen përpunim plastik të elementeve konstruktivë me pajisje dhe makina petëzuese. Ai/Ajo kryen përpunim mekanik të elementeve konstruktivë, montime të agregateve dhe konstruksioneve metalike, saldime dhe bashkime me ngjitje të materialeve, mirëmbajtje dhe riparime të makinerive/pajisjeve, si dhe riparime të thjeshta të konstruksionit. Përgatitësi/ja i/e konstruksioneve metalike përcakton radhën e punës, përzgjedh dhe përgatit veglat, pajisjet dhe makineritë e punës, kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo analizon, planifikon dhe koordinon punën me grupet e tjera, me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	

49	F3-III-24	Mirëmbajtje dhe riparime mekanike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Mekanikë, montues, riparues të makinave bujqësore dhe industriale	7233	Riparuesi/ja i/e makinerive metalpunuese, planifikon dhe organizon punën pasi ka analizuar dokumentacionin teknik të pajisjeve dhe makinerive, për të planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore të nevojshme, mjetet, veglat, pajisjet, materialet e punës, instrumentat matës dhe kontrollues, si dhe pjesët e këmbimit, në zbatim të detyrës. Ai/Ajo planifikon radhën dhe kohën e punës, ndan detyrat në ekip, organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike, si dhe bashkëpunon me specialistë të tjerë. Riparuesi/ja i/e makinerive metalpunuese kryen punime të planifikuara dhe në raste avarie duke identifikuar defektin nëpërmjet kontrollit vizual ose matjeve dhe duke kryer riparimet/zëvendësimet e nevojshme. Ai/Ajo rregullon funksionalitetin e makinerive pas riparimit duke testuar punën e makinerisë në produktin provë dhe kontrolluar përputhshmërinë e cilësisë së punimit me manualin e makinerisë. Riparuesi/ja i/e makinerive metalpunuese kryen mirëmbajtjen e makinerive, nëpërmjet pastrimit, vajosjes dhe grasatimit, ndërrimit/plotësimit të solucionit flohës dhe zëvendësimit të pjesëve të makinerive, sipas kalendarit të shërbimeve. Riparuesi/ja i/e makinerive metalpunuese kryen detyra administrative dhe tregtare, si dhe raporton tek eprorët mbi realizimet apo problematikat gjatë punës. Ai/Ajo diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Riparuesi/ja i/e makinerive metalpunuese zbaton regullat e sigurisë në punë, regullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve/shërbimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin e tij/saj profesional duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e riparimit të makinerive.	
50	F4-III-18	Metalurgji dhe fonderi	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të uzinave të përpunimit të metaleve dhe prodhimit të produkteve metalike	812		Punonjësit e uzinave të përpunimit të metaleve dhe prodhimit të produkteve metalike drejtojnë dhe monitorojnë makineritë dhe pajisjet që kanë funksion të vetëm kontrollin e proceseve kontrolluese, shndërruese, përpunuese dhe përfunduese të mineraleve jo metalikë ose metaleve.
51	F5-III-18	Teknologjia e përpunimit të metaleve	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë të përpunimit të metalit	8122		Punëtori/ja i/e përpunimit të metaleve vepron dhe manovron me makineri dhe pajisjet e duhura gjatë proceseve të punës në uzina të përpunimit të metaleve. Ai/Ajo kryen monitorimin, kontrollin e makinerive dhe pajisjeve dhe manovron me to për të ruajtur dhe siguruar parametrat teknikë të duhur të procesin e konvertimit të xeherorit mineral në metale, duke zbatuar rreptësisht rregullat përkatëse të sigurimit teknik për proceset e punës. Ai/Ajo mund të punësohet në uzina apo fabrika të përpunimit dhe shkrirjes së metaleve.
52	F-IV-25	Mekanikë	Program 1-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknikë të inxhinierisë mekanike	3115	Tekniku/ja i/e inxhinierisë mekanike planifikon dhe organizon punën duke përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës, materialet dhe pjesët e këmbimit, si dhe duke përcaktuar proceset dhe radhën e punës. Ai/Ajo mbikëqyr proceset e prodhimit të axhustimit, saldimit, fonderisë, deformimit plastik, si dhe mbikëqyr punimet me heqje ashkle dhe me teknologji speciale. Tekniku/ja i/e inxhinierisë mekanike mbikëqyr proceset e mirëmbajtjes dhe riparimeve mekanike, që nga procesi i çmontim/montimit, tek zëvendësimi, riparimi apo kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes. Ai/Ajo kontrollon cilësinë e produkteve të prodhuara, rregullsinë dhe kalibrimin e instrumentave matës, parregullsitë e produktit përfundimtar etj. Tekniku/ja i/e inxhinierisë mekanike kryen detyra administrative dhe tregtare, bashkëpunon me specialistë të tjerë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
53	G-II-22	Hoteleri-Turizëm	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtorë shërbimi dhe ndihmës në hotele dhe zyra dhe njësi të tjera	9112	Punonjësi/ja ndihmës/e në hoteleri-turizëm, mbështet shërbimet e ndryshme që realizohen në sektorin e mikpritjes, akomodimit, ushqimit dhe të turizmit, mirëpret dhe asiston klientin në hotel/restorant duke zbatuar rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale. Ai/Ajo përgatit dhe mirëmban vendin e punës në kuzhinë, përgatit asortimente të thjeshta në kuzhinë, përgatit dhe mirëmban banakun, përgatit dhe shërben pije të thjeshta, përgatit sallën dhe mjedise të tjera për shërbime, sipas llojit të aktivitetit, si dhe zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Ai/Ajo pastron dhe mirëmban mjediset në hotel, mjediset e përbashkëta të brendshme dhe të jashtme, ndihmon në procese të ndryshme në lavanderi, duke zbatuar rregullat e higjienës. Ai/Ajo bashkërendon punën me sektorë të tjerë, punon në grup, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale me kolegë dhe me eprorë, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Punonjësi/ja ndihmës/e në hoteleri-turizëm zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe ndihmon në sigurimin e cilësisë në shërbimet e kryera në sektorin mikpritjes, akomodimit, ushqimit dhe të turizmit.	
54	G1-III-24	Bar - Restorant	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kamarierë dhe banakierë	513	Kamarieri/ja planifikon dhe organizon vendin e punës, duke përcaktuar radhën e punës, duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, duke bashkëpunuar me palë të treta, si dhe duke ndarë detyrat në ekip. Ai/Ajo përgatit sallën në bar/restorant për shërbim, shërben në bar dhe restorant, si dhe realizon shërbime speciale në sy të klientit. Banakieri/ja planifikon dhe organizon vendin e punës, kontrollon gjendjen e banakut, harton fletëporosinë për magazinën, kontrollon cilësinë dhe sasinë e lëndëve të para dhe ndihmëse, merr në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse, sistemon lëndët e para dhe ndihmëse, mirëmban mjetet e punës dhe pajisjet në banak, si dhe mbikëqyr pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës. Ai/Ajo përgatit pije të ndryshme me ekspres, blender, mikser, shaker etj., shërben në banak, si dhe performon duke përdorur gotat, shishet dhe shaker-at. Kamarieri/ja dhe banakieri/ja kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton regullat e uniformës së punës, së higjienës personale dhe vendit të punës. Ai/Ajo zbaton regullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
55	G2-III-22	Kuzhinë - Pastiçeri	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kuzhinierë	512	Kuzhinieri/ja planifikon dhe organizon punën dhe vendin e punës, përzgjedh lëndët e para, ndihmëse, mjetet dhe pajisjet e punës, përgatit ëmbëlsirat, përgatit brumërat, salcat, buljonët dhe supat. Ai/Ajo përgatit gatime me mish, me peshk dhe prodhime deti, përgatit antipastat dhe gamiturat duke zbatuar teknika të ndryshme sipas recetës. Ai/Ajo ka përgjegjësi për realizimin e produktit nga momenti i marrjes në dorëzim të lëndëve të para e ndihmëse deri në realizimin përfundimtar të gatimit dhe prezantimit duke menaxhuar në mënyrë racionale burimet materiale, njerëzore dhe financiare. Kuzhinieri/ja kryen llogaritje të materialeve, kostos së produktit dhe llogaritje të tjera, përgatit preventiv për shërbime që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentacionet sipas formateve të kërkuara. Ai/Ajo koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së shërbimeve të kryera.	
56	G3-III-24	Recepsion	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Recepsionistë në hotele	4222	Recepsionisti/ja kryen organizimin dhe planifikimin e vendit të punës që në momentin që merr në dorëzim punën dhe deri në përfundimin e turnit. Ai/Ajo kryen rezervime, kryen regjistrimin (check in) e klientit, asiston klientin gjatë qëndrimit në hotel, trajton kërkesat dhe ankesat, si dhe kryen çregjistrimin (check out) e klientit. Recepsionisti/ja koordinon punën me sektorët e tjerë përbërës të strukturës akomoduese dhe kryen një sërë detyrash financiare dhe administrative, raporton tek eprori, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Recepsionisti/ja zbaton rregullat e uniformës së punës, së higjienës personale dhe vendit të punës. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për strukturat akomoduese. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
57	G4-IV-24	Guidë turistike	Program 2 vite për teknik/menaxher mesëm	Udhërrëfyes turistik	3335.03	Udhërrëfyesi/ja turistik/e është figurë profesionale e cila udhërrëfen për vizitorët në gjuhën që ata zgjedhin dhe interpreton trashëgiminë kulturore dhe natyrore të vendit ose një zone të caktuar. Udhërrëfyesi/ja turistik/e ofron shërbim profesional për vizitorët, tregon kujdes dhe përkushtim dhe duhet të jetë objektiv në prezantimin e vendit që vizitohet, të lirë nga paragjykimi apo propaganda. Ai/Ajo duhet të mbrojë imazhin turistik të vendit dhe të bëjë çmos që çdo grup turistik të respektojë mjedisin, faunën dhe florën, sitet dhe monumentet, dhe, gjithashtu, zakonet lokale dhe çështjet që konsiderohen si të ndjeshme, si dhe duhet të jetë i ndershëm dhe korrekt në ndërvepримet me të gjithë ata që janë të përfshirë në shërbimet e udhërrëfimit dhe me kolegët që punojnë në të gjitha fushat e turizmit. Udhërrëfyesi/ja turistik/e është përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm dhe sigurinë e vizitorëve gjatë gjithë kohës së udhëtimit, informimin e vizitorëve në çdo sit rreth sigurisë, rregullave dhe normave që kanë të bëjnë me kontrollet e sigurisë, kamerat, dhe çdo mjet që potencialisht është i rrezikshëm. Udhërrëfyesi/ja turistik/e është gjithashtu ambasadori i një emri të mirë të vendit që përfaqëson.	
58	G5-III-24	Shërbime në hotel dhe restorant	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kuzhinier/banakier/punonjës të tjerë të shërbimeve personale	512, 513, 515 dhe 516	Punonjësi/ja i/e kualifikuar në hotel dhe restorant, kryen planifikimin dhe organizimin e punës, harton menu-në dhe planin ditor, parashikon dhe përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, si dhe i sistemon ato në vendin e punës, ndan detyrat në ekip apo bashkëpunon me të tjerë. Punonjësi/ja i/e kualifikuar në hotel dhe restorant përgatit asortimente në kuzhinë, kryen shërbime në bar, në restorant dhe në recepsion. Ai/Ajo mbikëqyr shërbimet e pastrimit në dhomë dhe në mjediset e përbashkëta, shërbimet e larjes, tharjes dhe hekurosjes së biankerive dhe robave të klientit, si dhe asiston klientin gjatë qëndrimit në hotel. Punonjësi/ja i/e kualifikuar në hotel dhe restorant kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregulloren e brendshme për pajisjen me uniformën e punës dhe regullat e higjienës personale dhe të vendit të punës. Ai/Ajo zbaton regullat e sigurisë në punë, regullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për strukturat akomoduese. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
59	G6-IV-24	Shërbime udhëtimi dhe turizmi	Program 2 vite për teknik/menaxher mesëm	Operator turistik	3335	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në operator turistik planifikon dhe organizon punën, lidhur me veprimtarinë ditore, javore dhe mujore, planifikimin e mjeteve dhe pajisjeve për ushtrimin e veprimtarisë, përcaktimit të prioriteteve të ditës, menaxhimit të kohës, si dhe ndarjes së detyrave në ekip. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në operator turistik përcakton qëllimin e studimit dhe tregun potencial, si dhe kryen hulumtimin e tregut për të grumbulluar informacion për produktin turistik, për konkurrentët, për furnitorët, për detajet logjistike të destinacionit, për historinë, gjeografinë, trashëgiminë kulturore, arkitekturën etj. Ai/Ajo përpunon informacionin e grumbulluar në mënyrë që të përshtatë produktin. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në operator turistik krijon produktin turistik dhe kryen blerjen e produkteve dhe shërbimeve si: shërbimet e akomodimit, të transportit, të guidës, shërbimet gastronomike apo shërbime të tjera shtesë. Ai/Ajo kryen tregtimin (marketimin) e produktit duke përzgjedhur trende të promovimit dhe kanalet e shpërndarjes, menaxhuar publikimet promocionale në web, në social media, në panairet e përzgjedhura etj., si dhe shet produktet turistike. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në operator turistik kryen veprime administrative dhe financiare, zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, harton planin e menaxhimit të riskut për ruajtjen e sigurisë së klientëve, stafit dhe sigurisë në punë, si dhe garanton standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera. Ai/Ajo planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton rregulloren e brendshme dhe politikat e agjencisë, legjislacionin në fuqi, si dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët.	
60	G7-III-24	Pastiçeri	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Pastiçier dhe të tjerë të ngjashme me to	7514	Pastiçieri/ja kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke planifikuar dhe përzgjedhur lëndët e para, ndihmëse, mjetet, materialet, pajisjet e punës, burimet njerëzore, duke ndarë detyrat në ekip dhe bashkëpunuar me specialistë të tjerë në zbatim të planit të prodhimit dhe planit ditor. Pastiçieri/ja përgatit brumërat, kremrat, salcat, akulloret, ëmbëlsirat gjysmë të ngrira, prodhimet e sheqerit, produktet me çokollatë, prodhimet në pastiçeri dhe kryen përpunimin e frutave/perimeve. Pastiçieri/ja kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregulloren e brendshme për përdorimin e uniformës së punës, rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për fushën ku ushtron veprimtarinë. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	

61	G8-III-24	Kuzhinë	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Kuzhinierë	5120	Kuzhinieri/ja planifikon dhe organizon punën dhe vendin e punës, përzgjedh lëndët e para, ndihmëse, mjetet dhe pajisjet e punës, përgatit ëmbëlsirat, përgatit brumërat, salcat, buljonët dhe supat. Ai/Ajo përgatit gatime me mish, me peshk dhe prodhime deti, përgatit antipastat dhe garniturat duke zbatuar teknika të ndryshme sipas recetës. Ai/Ajo ka përgjegjësi për realizimin e produktit nga momenti i marrjes në dorëzim të lëndëve të para e ndihmëse deri në realizimin përfundimtar të gatimit dhe prezantimit duke menaxhuar në mënyrë racionale burimet materiale, njerëzore dhe financiare. Kuzhinieri/ja kryen llogaritje të materialeve, kostos së produktit dhe llogaritje të tjera, përgatit preventiv për shërbime që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentacionet sipas formateve të kërkuara. Ai/Ajo koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së shërbimeve të kryera.	
62	G9-III-24	Hoteleri	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Kuzhinier/banakier/punonjës të tjerë të shërbimeve personale	512, 513, 515 dhe 516	Punonjësi/ja i/e kualifikuar në hotel dhe restorant, kryen planifikimin dhe organizimin e punës, harton menu-në dhe planin ditor, parashikon dhe përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, si dhe i sistemon ato në vendin e punës, ndan detyrat në ekip apo bashkëpunon me të tjerë. Punonjësi/ja i/e kualifikuar në hotel dhe restorant përgatit asortimente në kuzhinë, kryen shërbime në bar, në restorant dhe në recepsion. Ai/Ajo mbikëqyr shërbimet e pastrimit në dhomë dhe në mjediset e përbashkëta, shërbimet e larjes, tharjes dhe hekurosjes së biankerive dhe robave të klientit, si dhe asiston klientin gjatë qëndrimit në hotel. Punonjësi/ja i/e kualifikuar në hotel dhe restorant kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregulloren e brendshme për pajisjen me uniformën e punës dhe rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për strukturat akomoduese. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
63	G10-III-24	Shërbime ushqimi dhe pije	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Kamarierë dhe banakierë	513	Kamarieri/ja planifikon dhe organizon vendin e punës, duke përcaktuar radhën e punës, duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, duke bashkëpunuar me palë të treta, si dhe duke ndarë detyrat në ekip. Ai/Ajo përgatit sallën në bar/restorant për shërbim, shërben në bar dhe restorant, si dhe realizon shërbime speciale në sy të klientit. Banakieri/ja planifikon dhe organizon vendin e punës, kontrollon gjendjen e banakut, harton fletëporosinë për magazinën, kontrollon cilësinë dhe sasinë e lëndëve të para dhe ndihmëse, merr në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse, sistemon lëndët e para dhe ndihmëse, mirëmban mjetet e punës dhe pajisjet në banak, si dhe mbikëqyr pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës. Ai/Ajo përgatit pije të ndryshme me ekspres, blender, mikser, shaker etj., shërben në banak, si dhe performon duke përdorur gotat, shishet dhe shaker-at. Kamarieri/ja dhe banakieri/ja kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e uniformës së punës, së higjienës personale dhe vendit të punës. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
64	G-IV-25	Hoteleri-Turizëm	Program 1-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Drejtues në hotele	1411	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në hotel dhe restorant kryen planifikimin, organizimin dhe koordinimin e punës duke mbikëqyrur përgatitjen e ambienteve për punë, duke hartuar agjendën ditore, duke planifikuar vepримtaritë ditore, si dhe duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore dhe burimet e tjera për proceset e punës. Ai/Ajo koordinon punën për sigurimin e burimeve të tjera, koordinon oraret e punës dhe mbledh informacion për mbarëvajtjen e punës. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në hotel dhe restorant mbikëqyr shërbimin në bar dhe restorant, shërbimin në recepsion, si dhe shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes. Ai/Ajo monitoron/siguron përmbushjen e detyrave operative në kuzhinë, koordinon punët për realizimin e eventeve, si dhe koordinon punën për aspekte të shitjes dhe marketingut. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në hotel dhe restorant kryen veprime administrative dhe financiare, si dhe bashkëpunon me palë të treta dhe specialistë të tjerë duke zbatuar rregullat e komunikimit etik dhe profesional. Ai/Ajo garanton zbatimin e regullave të shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe rregullave të mbrojtjes së mjedisit. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të vetes dhe stafit, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.	
65	G1-V-24	Menaxhim i strukturave akomoduese	Programe, pas të mesme 1-vjeçar studimi	Menaxher i mesëm në struktura akomoduese	1411.1	Menaxheri/ja i/e mesëm/me i/e strukturës akomoduese kryen planifikimin dhe organizimin e punës, mbikëqyr shërbimin në sektorin e ushqimit dhe pijes, në recepsion, shërbimet e pastrimit dhe bashkërendon punën për organizimin e eventeve. Ai/Ajo koordinon punën me sektorin e financës, me departamentin e shitjes dhe marketingut, mbikëqyr shërbimet e rekreacionit dhe zbavitjes dhe shërbimet e mirëmbajtjes të strukturës akomoduese duke siguruar cilësinë e shërbimeve në të. Menaxheri/ja i/e strukturës akomoduese diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim. Ai/Ajo mbikëqyr zbatimin e rregullave të higjienës, sigurisë në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi të fushës përkatëse. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja të fushës.	
66	G2-V-25	Menaxhim i shërbimit për ushqim dhe pije	Program, pas të mesme 1-vjeçar studimi	Drejtues në restorante	1412	Menaxheri/ja për shërbime në ushqim dhe pije kryen planifikimin dhe organizimin e punës, menaxhon personelin/stafin, koordinon aktivitetin me departamentet e tjera, si dhe mbikëqyr organizimin e sallës. Ai/Ajo mbikëqyr inventarin e pajisjeve dhe bazës materiale, menaxhon kostot, harton listën e pijeve, siguron cilësinë e shërbimit dhe kryen detyra administrative dhe tregtare. Menaxheri/ja për shërbim në ushqim dhe pije diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim. Ai/Ajo mbikëqyr zbatimin e rregullave të higjienës, sigurisë në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi të fushës përkatëse. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja të fushës.	
67	G3-V-25	Menaxhim eventesh	Program, pas të mesme 1-vjeçar studimi	Menaxher eventesh	3332.1	Menaxheri/ja i/e eventeve realizon krijimin e konceptit të eventit, planifikimin dhe zbatimin e tij. Ai/Ajo identifikon objektivat e eventit, target audiencën, mjetet, burimet dhe partnerët për realizimin e eventit, përcakton llojin e eventit dhe harton planin e detajuar për çdo fazë të eventit. Ai/Ajo menaxhon buxhetin e eventit, vendin e zhvillimit të eventit, logjistikën, stafin e eventit dhe situatat e paparashikuara. Menaxheri/ja i/e eventeve mbikëqyr shitjen dhe marketimin e eventit, mbikëqyr eventin dhe vlerëson eventin. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me klientët, bashkëpunëtorët, stafin, si dhe komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Menaxheri/ja i/e eventeve kryen detyra administrative dhe tregtare, dokumenton punën e kryer dhe raporton mbi realizimet e kryera. Ai/Ajo ngre vazhdimisht nivelin profesional të vetes dhe stafit, si dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
68	G4-V-26	Shërbime mikpritje dhe turizmi	Program pas i mesëm 1-vjeçar studimi	Menaxher në agjenci udhëtimi	1439.01 dhe 4224.07	Menaxheri/ja i/e agjencisë së udhëtimit planifikon dhe organizon punën, lidhur me veprimtarinë ditore, javore dhe mujore, planifikimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve për ushtrimin e veprimtarisë, përcaktimin e prioriteteve të ditës, menaxhimin e kohës, si dhe ndarjen e detyrave në ekip. Ai/Ajo monitoron realizimin e planit të punës, bashkëpunon me specialistë të tjerë dhe raporton për mbarëvajtjen e punës. Menaxheri/ja i/e agjencisë së udhëtimit studion tregun për të grumbulluar informacion për produktin turistik, për tregun turistik, për furnitorët, për klientët potencialë, me qëllim identifikimin e mundësive për zhvillimin e produkteve turistike. Menaxheri/ja i/e agjencisë së udhëtimit krijon produktet dhe paketat turistike, kryen blerjen e shërbimeve turistike, si dhe shet shërbimet dhe paketat. Ai/Ajo kryen marketimin e veprimtarisë dhe identitetit, duke përzgjedhur kanalet e shpërndarjes, duke hartuar strategjinë dhe planin e marketingut, duke menaxhuar publikimet promocionale në web, në mediat sociale, në panairet e përzgjedhura etj.. Menaxheri/ja i/e agjencisë së udhëtimit kryen veprime administrative dhe financiare, zbaton parimet e turizmit të qëndrueshëm, harton planin e menaxhimit të riskut për ruajtjen e sigurisë së klientëve, stafit dhe sigurisë në punë, si dhe garanton standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera. Ai/Ajo planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton legjislacionin në fuqi, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo ngre nivelin profesional duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
69	H-II-22	Bujqësi	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtorë të bujqësisë	921	Punëtori/ja në bujqësi kryen përgatitjen e tokës, mbjelljen dhe kultivimin e kulturave bujqësore të tilla si: perime, pemë frutore, bimë barishtore, bimë mjekësore e aromatike, si dhe kujdeset për blegtorinë (lopët, delet, derrat, dhitë, kuajt, shpendët, peshqit, bletët etj.). Ai/Ajo kryen shërbime të ndryshme për kulturat bujqësore si: plehërim, spërkatje, ujitje, krasitje, lidhje apo vendosje të kunjave, pastrim, monitorim të sëmundjeve dhe dëmtuesve në produktet bujqësore, monitorim të shkallës së pjekjes, vjeljen/korrjen dhe mbledhjen e prodhimeve bujqësore. Punëtori/ja në bujqësi kujdeset për rritjen, ushqyerjen, mirëqenien e kafshëve dhe shpendëve apo specieve të tjera me interes ekonomik, identifikon simptomat e lëndimit ose sëmundjes së tyre dhe informon specialistët përkatës për to. Ai/Ajo kryen punë fizike, përdor pajisje të ndryshme për punime në bujqësi dhe blegtori, mirëmban ose asiston në mirëmbajtjen e objekteve dhe infrastrukturës së fermës, zonat e strehimit të kafshëve duke përfshirë pastrimin e stallave, hambarëve, pastrimin dhe dezinfektimin e kafazeve, mirëmbajtjen e kanaleve, tubacioneve, pompave etj. Punëtori/ja në bujqësi kryen përpunime të thjeshta të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, kryen paketimin, ambalazhimin dhe etiketimin e tyre, transportin dhe shpërndarjen e produkteve në treg. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera, në komunikimin me të tjerët. Punëtori/ja në bujqësi zbaton bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale bujqësore, masat e duhura të sigurisë ushqimore, procedurat e biosigurisë, rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.	
70	H1-III-24	Frutikulturë	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kultivues të pemëve frutore	6113	Kultivuesi/sja i/e pemëve frutore kryen planifikimin dhe organizimin e punës, bashkëpunon në vlerësimin e kushteve mjedisore të fermës, prodhon fidanët e pemëve frutore, përgatit tokën, mbjell fidanët dhe mbikëqyr kryerjen e shërbimeve agroteknike. Ai/Ajo mbikëqyr procesin e vjeljes së prodhimit, kryen procese të përpunimit të thjeshtë të prodhimit dhe zbaton teknologjinë e prodhimit biologjik duke siguruar cilësinë e shërbimeve të kryera. Kultivuesi/sja i/e pemëve frutore diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton të gjithë legjislacionin në fuqi për fushën përkatëse. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
71	H2-III-24	Ferma bujqësore dhe blegtorale	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Prodhues në fermat bujqësore dhe blegtorale	6132	Prodhuesi/ja në fermat bujqësore dhe blegtorale kryen planifikimin dhe organizimin e punës, mbikëqyr dhe zbaton teknologjitë e prodhimit bimor, blegtoral dhe biologjik duke përdorur makineri të thjeshta, mjete dhe pajisjet e punës. Ai/Ajo mbikëqyr dhe zbaton proceset e përpunimit të thjeshtë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, si dhe përdor teknologjitë bashkëkohore dhe digjitale në veprimtarinë e vet. Prodhuesi/ja në fermat bujqësore dhe blegtorale diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton të gjithë legjislacionin në fuqi në fushat përkatëse. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushave.	
72	H3-III-19	Mbarështimi i kafshëve dhe shpendëve	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Rritës të kafshëve dhe shpendëve dhe të ngjashme me to	612		Rritësit e kafshëve dhe shpendëve dhe të ngjashme me to kryejnë veprime të nevojshme për mbarështimin, rritjen dhe kujdesin ndaj bagëtive, shpendëve dhe të ngjashme me to si: kafshët shtëpiake, një thundrakët, delet, derrat, dhitë, kuajt, qentë, macet, zvarranikët, shpendët, shpendët apo kafshët e egra, etj. që do të përdoren për punë, sport, për mish, qumësht, lesh, lëkurë dhe produkte tjera, për shitje në treg apo përdorime vetjake. Ata/Ato mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve blegtorale apo të vetëpunësohet.

73	H5-III-24	Kopshtari	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kopshtar, kultivues të kopshtarisë dhe fidanëve	6114	Kultivuesi/ja i/e kopshtarisë dhe fidanëve kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet, pajisjet e punës dhe burimet njerëzore, si dhe duke përcaktuar kohën dhe radhën e punës sipas veprimtarisë ditore, javore dhe mujore të punës. Ai/Ajo ndan detyrat në ekip dhe bashkëpunon me eprorin dhe specialistë të tjerë. Kultivuesi/ja i/e kopshtarisë dhe fidanëve kryen analiza agroklimatike tokësore dhe ujore, kryen përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e farave/fidanëve, prodhon fidanë të bimëve zbukuruese dhe dekorative, kryen shërbime agroteknike pas mbjelljes, si dhe zbaton proceset e marrjes së prodhimit. Kultivuesi/ja i/e kopshtarisë dhe fidanëve kryen detyra administrative dhe financiare, dokumenton punën e kryer dhe raporton tek eprori. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për fushën ku ushtron veprimtarinë. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
74	H6-III-24	Prodhim bimor	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kultivues të perimeve dhe bimëve të arave	6112	Kultivuesi/ja i/e perimeve dhe bimëve të arave kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet, pajisjet e punës dhe burimet njerëzore, si dhe duke përcaktuar kohën dhe radhën e punës sipas veprimtarisë ditore, javore dhe mujore të punës. Ai/Ajo ndan detyrat në ekip dhe bashkëpunon me eprorin dhe specialistë të tjerë. Kultivuesi/ja i/e perimeve dhe bimëve të arave vlerëson kushtet mjedisore, prodhon fidanë perimorë dhe/ose të bimëve të arave, përgatit tokën për mbjellje, kryen procesin e mbjelljes, kryen shërbime agroteknike, si dhe zbaton proceset përfundimtare të marrjes së prodhimit. Kultivuesi/ja i/e perimeve dhe bimëve të arave kryen detyra administrative dhe financiare, dokumenton punën e kryer dhe raporton tek eprori. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për fushën ku ushtron veprimtarinë. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
75	H8-IV-25	Agroturizëm	Program 2-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Kultivues të varieteteve të përziera për nevoja familjare (Agroturizëm)	6330	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në agroturizëm kryen planifikimin dhe organizimin e punës, menaxhon strukturat akomoduese në agroturizëm, menaxhon fermën bujqësore dhe blegtorale në agroturizëm. Ai/Ajo mbikëqyr procese të përpunimit të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, zbaton teknologjinë e prodhimit biologjik duke siguruar cilësinë e kërkuar, mbikëqyr realizimin e aktiviteteve argëtuese agroturistike, kryen marketingun dhe shitjen e produkteve. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në agroturizëm diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton legjislacionin në fuqi për fushën përkatëse. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe trendet e zhvillimit në fushën e agroturizmit.	
76	H9-III-18	Shërbime kujdesi për kafshët	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë të fermave blegtorale	9212		Punëtorë të fermave blegtorale kryejnë punë rutinë në fermat blegtorale. Ata/Ato kujdesen për ushqimin, pastrimin, mirëqenien e kafshëve dhe sigurojnë, mbledhin dhe paketojnë prodhimet e tyre. Ata mirëmbajnë në tërësi mjedisin në ferma.
77	H10-IV-25	Teknologjia bujqësore	Program 2-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Përdorues të makinave të ndryshme bujqësore	8341	Agromekanizatori/ja (Punëtori/ja e makinave të ndryshme bujqësore) përdor, menaxhon dhe monitoron një ose më shumë lloje agregate bujqësorë që përdoren në procese të ndryshme bujqësore. Ai/Ajo vë në funksion, drejton dhe kujdeset për traktorin apo makineritë e tjera të fermës bujqësore për sistemimin e tokës, për përgatitjen e tokës për mbjellje, për mbjelljen, për plehërimin, spërkatjen apo/dhe ujitjen, për vjeljen/korrjen/shkuljen e prodhimit, për kryerjen e transportit, manipulimit, depozitimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësorë. Agromekanizatori/ja kryen përgatitjen, lidhjen, bashkimin, regjistrimin e agregatit, makinerisë, pajisjes dhe mjeteve të punës për procese të ndryshme, mirëmban makineritë dhe kryen riparime të thjeshta. Agromekanizatori/ja analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi, Ai/ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
78	H-IV-25	Bujqësi	Program 1-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Drejtues në ferma me kualifikim miks (bujqësore dhe blegtorale)	6131.03	Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi planifikon, organizon dhe koordinon punën duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës, si dhe duke përcaktuar proceset dhe radhën e punës. Ai/Ajo menaxhon fermën bujqësore, fermën blektorale, fermat e mitjes së peshkut dhe fermën organike. Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi menaxhon kopshtet dekorative, si dhe kontrollon cilësinë e prodhimeve bujqësore dhe blektorale, duke kontrolluar cilësinë e prodhimit të bimëve të arave, prodhimit të perimeve, prodhimit të drurëve frutorë, prodhimit të bimëve aromatike dhe mjekësore, prodhimit të qumështit, prodhimit të vezëve, prodhimit të mishit, të peshkut, midhjeve dhe karkalecave, prodhimit të mjaltit, prodhimit të fijes së mëndafshit etj. Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi kryen detyra administraive dhe tregtare, bashkëpunon me specialistë të tjerë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së produkteve/shërbimeve të ofruara.	
79	H/1-IV-22	Agrobiznes	Programe 4 vjeçar studimi për teknik/menaxher mesëm	Kultivues i kulturave bujqësore dhe kopshtarë për treg	611		Kultivuesi/ja i/e kulturave bujqësore dhe kopshtarë për treg planifikon organizon dhe kryen punët që lidhen me rritjen dhe korrjen e kulturave bujqësore. Ai/Ajo realizon të gjitha proceset e punës së nevojshme për një zhvillim normal të kulturave që nga procesi i mbjelljes deri në mbledhjen vjeljen e prodhimit duke njohur mirë fazat biologjinë e zhvillimit të tyre dhe përdorimin e mjeteve apo makinerive bujqësore. Ai/Ajo mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohen.
80	H1-V-23	Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor	Programe pas të mesëm një vjeçar	Menaxherë dhe mbikëqyrës i prodhimeve bujqësore	6111	Menaxheri/ja dhe mbikëqyrësi/ja i/e prodhimeve bujqësore analizon, planifikon dhe organizon aktivitete në fushën e prodhimit bujqësor. Ai/Ajo siguron dhe menaxhon burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare për kryerjen e aktivitetit. Menaxheri/ja dhe mbikëqyrësi/ja i/e prodhimeve bujqësore monitoron zbatimin e teknologjive të prodhimit bujqësor duke filluar nga procesi i përgatitjes së tokës për mbjelljen, procesi i mbjelljes, kryerja e shërbimeve të ndryshme, vjeljen, klasifikimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve të prodhimit bujqësor. Menaxheri/ja dhe mbikëqyrësi/ja i/e prodhimeve bujqësore monitoron zbatimin e standardeve të pas vjeljes dhe zbatimin e standardeve të sigurimit të cilësisë së produktit bujqësor. Ai/Ajo mbikëqyr përdorimin e pajisjeve dhe veglave të punës për punime bazë dhe plotësuese bujqësore. Menaxheri/ja dhe mbikëqyrësi/ja i/e prodhimeve bujqësore diskuton me kolegët, vartësit, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale bujqësore, kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve dhe shërbimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentacionet e duhura. Ai/ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e bujqësisë.	
81	I-II-20	Gjeologji -Miniera	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës të uzinave dhe përdorues të makinerive dhe pajisjeve	81		Punonjësi/ja i/e uzinave dhe përdoruesi/ja i/e makinerive dhe pajisjeve operon në makineri dhe pajisje të palëvizshme, punon në to dhe monitoron punën e tyre. Ai/Ajo punon në miniera, në uzina të përpunimit të metaleve, të përpunimit të mineraleve, të përpunimit të naftës dhe gazit, të prodhimit të tekstileve, lëkurës dhe gëzofit, të qelqit, të qeramikës, të drurit, të letrës, të përpunimin e ujit, të prodhimit të produkteve ushqimore me makineri, etj.
82	I1-III-20	Miniera	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Minatorë dhe punonjës të gurores	8111		Minatori/ja dhe punëtori/ja i/e gurores merret me shpimin e birave për hapjen e punimeve minerare dhe të rrëzimit të mineralit, kontrollin e galerisë për kushte të sigurta pune duke punuar i organizuar në grup dhe duke përdorur pajime mbrojtëse personale në vendin e punës. Ai/Ajo përdor makineri dhe pajisje të thjeshta dore duke zbatuar reptësisht rregullat e sigurimit teknik. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani minerare (në nëntokë dhe sipërfaqe) në pozicione pune të tilla si: minator dhe armator në punime minerare, në rrëzimin e mineralit, si dhe në transportimin e tij nga galeria në ambientin e grumbullimit të prodhimit.
83	I2-III-16	Markshajderi	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të uzinave dhe përdorues të makinerive dhe pajisjeve	81		Punonjësi/ja i/e uzinave dhe përdoruesi/ja i/e makinerive dhe pajisjeve operon në makineri dhe pajisje të palëvizshme, punon në to dhe monitoron punën e tyre. Ai/Ajo punon në miniera, në uzina të përpunimit të metaleve, të përpunimit të mineraleve, të përpunimit të naftës dhe gazit, të prodhimit të tekstileve, lëkurës dhe gëzofit, të qelqit, të qeramikës, të drurit, të letrës, të përpunimin e ujit, të prodhimit të produkteve ushqimore me makineri, etj.
84	I3-III-16	Gjeologji	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të uzinave dhe përdorues të makinerive dhe pajisjeve	81		Punonjësi/ja i/e uzinave dhe përdoruesi/ja i/e makinerive dhe pajisjeve operon në makineri dhe pajisje të palëvizshme, punon në to dhe monitoron punën e tyre. Ai/Ajo punon në miniera, në uzina të përpunimit të metaleve, të përpunimit të mineraleve, të përpunimit të naftës dhe gazit, të prodhimit të tekstileve, lëkurës dhe gëzofit, të qelqit, të qeramikës, të drurit, të letrës, të përpunimin e ujit, të prodhimit të produkteve ushqimore me makineri, etj.
85	I-IV-23	Gjeologji -Miniera	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Përgjegjës (mbikëqyrës) në miniera	312	Përgjegjësi/ja në minierë planifikon dhe organizon punën duke filluar me proceset dhe kohën e punës, burimet njerëzore të nevojshme, bazën materiale, mjetet, makineritë dhe pajisjet sipas proceseve të punës. Ai/Ajo harton dhe mbikëqyr zbatimin e urdhrave të punës dhe raporton mbi ecurinë e proceseve të saj. Përgjegjësi/ja në minierë mbikëqyr punimet në kërkim-zbulim, punimet e hapjes dhe përgatitjes, punimet e shfrytëzimit, punimet e armatimit dhe shtrimit të shinave në nëntokë dhe sipërfaqe. Ai/Ajo bashkëpunon dhe mbikëqyr procesin e ajrimit në minierat nëntokësore, proceset e ngarkim-shkarkimit dhe transportit, si dhe punimet ndihmëse e të mirëmbajtjes (armatimit, shtrimit të shinave, pastrimit të ujërave, sistemin elektrik). Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e gjeologji - minierave.	
86	J-II-20	Detari	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtorë në peshkim	9216		Punëtorë në peshkim dhe akuariumesh kryejnë detyra të thjeshta rutinë për të ushqyer, kultivuar, kapur peshk dhe për ta grumbulluar atë për shitje. Ata/Ato mbledh alga deti, myshk deti, butakë dhe molusqeve të tjera dhe kryen veprime peshkimi në brigjet dhe në thellësitë e detit apo edhe në basene të ndërtuara për ritjen e peshkut.
87	J1-III-21	Peshkim	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës peshkimi	622	Peshkatari/ja i/e kualifikuar kryen shërbime në mjetin lundrues kur mjeti është në port, kur mjeti lundrues është në manovër, në lundrim, në gjueti, në proces riparim-dokimi si dhe kur mjeti lundrues është për/në vend-spirancë. Ai/Ajo mirëmban sektorin e kuvertës/makinerisë dhe zbaton rregullat e sigurimit të jetës, pronës dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton rregullat e sigurisë së mjetit lundrues në port dhe në lundrim. Peshkatari/ja i/e kualifikuar kryen shërbime për aktivitetin ekonomik të mjetit lundrues në port, zbaton urdhrat dhe raporton te eprorët, si dhe koordinon punën me kolegë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	

88	J2-III-17	Teknikë peshkimi	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Teknikë peshkimi	3144		Teknikët në shkencat e jetës kryejnë një sërë funksionesh teknike për të mbështetur profesionistët e shkencave të jetës me kërkime, zhvillime, administrime, detyra të ruajtjes mjedisore në fusha të tilla si biologjia, botanika, zoologjia, bioteknologjia dhe biokimia, si edhe në bujqësi, peshkim dhe pyje. Teknikët në shkencat e jetës mund të punësohen në ferma ose kompani të mëdha bujqësore, si edhe në agjenci dhe institucione shtetërore përgjegjëse për bujqësinë dhe pyjet.
89	J-IV-23	Detari	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Punonjës peshkimi në thellësi (det të hapur)	6223	Punonjësi/ja i/e peshkimit në thellësi (det të hapur) kryen shërbime të karakterit organizativ, mbikëqyrës dhe teknik që lidhen me aktivitetin e mjetit lundrues të peshkimit kur mjeti është në port, kur është në manovër, në lundrim, si dhe kur mjeti lundrues është për/në vend-spirancë. Ai/Ajo mbikëqyr përgatitjen për lundrim, sigurinë në lundrim, mbarëvajtjen e gjuetisë, mirëmbajtjen e sektorit të kuvertës/makinerisë, zbatimin e regullave të sigurimit të jetës, pronës dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe të regullave për sigurinë e mjetit lundrues në port dhe në lundrim. Punonjësi/ja i/e peshkimit në thellësi (det të hapur) kryen shërbime për aktivitetin ekonomik të mjetit lundrues në port, raporton te eprorët, si dhe bashkërendon punën me kolegë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi.	
90	J1-V-14	Shërbime detare në kuvertë	Programe pas të mesëm 1 vit	Pilotë dhe oficerë anijesh	3152		Pilotët dhe oficerët e anijeve komandojnë dhe manovrojnë anije dhe mjete lundruese të ngjashme, si edhe kryejnë funksione të ngjashme në breg. Ata/Ato punësohen në kompani private apo shtetërore të transportit ujor, si dhe institucione rregulluese të trafikut ujor.
91	K-IV-15	Elektronikë	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknik elektronik	3114.05		Tekniku/ja i/e inxhinierisë elektronike dhe telekomit kryen detyra teknike për të ndihmuar punën kërkimore në elektronikë, si në projektimin, prodhimin, montimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, riparimin, eliminimin e defekteve të aparaturave, pajisjeve elektronike apo komponentëve të tyre, nën mbikëqyrjen e inxhinierëve. Tekniku/ja i/e inxhinierisë elektronike dhe telekomit mund punësohet në sektorë të ndryshëm të fushës elektronike dhe telekomit apo të vetëpunësohet.
92	L-II-21	Ekonomi-Biznes	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Ndihmës në ekonomi biznes	411	Punonjësi/ja ndihmës/e në ekonomi biznes organizon vendin e punës, duke marrë detyrën, marrë në dorëzim mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, testuar pajisjet e punës për funksionalitetin e tyre, duke zbatuar agjendën ditore dhe konsultuar ndryshimet e nevojshme në agjendë. Punonjësi/ja ndihmës/e në ekonomi biznes kryen veprimet në magazinë, kryen veprime të procedurës së blerjes dhe shitjes, ndihmon në marrëdhëniet me klientët dhe furnitorët, ndihmon në regjistrimin e veprimeve të biznesit dhe ndihmon në në kryerjen e pagesave dhe arkëtimeve. Punonjësi/ja ndihmës/e në ekonomi biznes dokumenton dhe raporton punën e kryer, si dhe komunikon me eprorë dhe kolegë duke zbatuar rregullat e komunikimit etik dhe profesional. Ai/Ajo zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Punonjësi/ja ndihmës/e në ekonomi biznes zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.	
93	L2-IV-23	Sigurime	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Përfaqësues sigurimesh	3321	Përfaqësuesi/ja i/e sigurimeve planifikon dhe organizon punën në njësinë e vet, lidhur me vepримtarinë javore, mjetet dhe pajisjet e punës për ushtrimin e veprimtarisë, burimet njerëzore të nevojshme, prioritetet e ditës, ndarjen e detyrave në ekip, si dhe përgatitjen e mjedisit për pritjen e klientit. Ai/Ajo kërkon informacion për tu njohur me klientët potencialë biznese ose individë, konkurrentët dhe planin e zhvillimit të zonës. Përfaqësuesi/ja i/e sigurimeve kryen marketingun e produkteve duke shpërndarë informacion dhe materiale promovuese, duke marrë pjesë në panaire të ndryshme, duke organizuar takime dhe fushata ndërgjegjësimi. Ai/Ajo kryen negocimin dhe shitjen e produkteve si: sigurime të përgjegjësisë ndaj palëve të treta (e detyrueshme), sigurime të personit, sigurime të pronës, sigurime të garancive, sigurime të jetës. Përfaqësuesi/ja i/e sigurimeve zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe garanton standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera. Ai/Ajo planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë, me eprorë dhe me klientë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton rregulloren e brendshme dhe politikat e kompanisë, legjislacionin në fuqi, si dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët.	
94	L3-IV-24	Shërbime bankare	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Arkëtarë banke dhe nëpunës të tjerë që lidhen me të	4211	Arkëtari/ja e bankës dhe nëpunësit e tjerë që lidhen me të kryen organizimin e punës duke filluar me zbatimin e kodit etik të veshjes dhe të paraqitjes së jashtme, duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, menaxhuar kohën dhe duke bashkëpunuar me specialistë të tjerë. Arkëtari/ja e bankës dhe nëpunësit e tjerë që lidhen me të kryen çeljen e arkës, kryen shërbime bankare ndaj klientit, përpunimin e kesh-it, kryen procedurat për rastet e dyshimta dhe kryen procedurat e mbylljes së arkës. Arkëtari/ja e bankës dhe nëpunësit e tjerë që lidhen me të kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton dhe raporton vazhdimisht për punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët, ruan dhe trajton me konfidencialitet të dhënat e klientëve dhe bankës, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në bankë dhe sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin në fuqi për fushën ku ushtron veprimtarinë. Ai/ajo angazhohet të rrisë kapacitetet profesionale duke marrë pjesë në programet trajnuese dhe duke u përditësuar me zhvillimet e reja të fushës.	
95	L4-IV-23	Llogari	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Llogaritar	3313	Llogaritari/ja planifikon dhe organizon punën në varësi të veprimtarisë së ndërmarrjes ku punon, administron dokumentacionin, përdor software dhe programe për regjistrimin e të dhënave, plotëson dokumente financiare, kryen procedura llogaritëse dhe inventarizime, si dhe pagesa dhe arkëtime. Ai/Ajo plotëson dhe administron regjistrat financiare dhe regjistrin e personelit, përgatit dhe mirëmban dokumente shkresore, duke përdorur mjete, pajisje apo software dhe programe të ndryshme në funksion të realizimit të veprimtarisë së vet. Llogaritari/ja planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton rregulloren e brendshme dhe politikat e organizatës, legjislacionin në fuqi, si dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
96	L5-IV-23	Sipërmarrje e agjencisë turistike	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Nëpunës në agjencitë e udhëtimit	4224	Nëpunësi/ja në agjencitë e udhëtimit planifikon dhe organizon punën në njësinë e vet, lidhur me veprimtarinë ditore, javore dhe mujore, mjetet dhe pajisjet për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe ndarjes së detyrave në ekip. Ai/Ajo siguron informacion mbi tregjet e shitjes dhe blerjes, kryen blerje dhe shitje të produkteve dhe shërbimeve në fushën e turizmit, krijon produktet turistike, si dhe marketon produktin dhe shërbimet e agjencisë. Nëpunësi/ja në agjencitë e udhëtimit kryen veprime financiare dhe kontabël si: llogaritja e kostove të paketave dhe shërbimeve, llogaritja e çmimeve të produkteve, llogaritja e TVSH, kryerja e pagesave cash dhe me transfertë bankare, si dhe përdorimi i programeve software të ndryshëm në funksion të realizimit të veprimtarisë së vet. Nëpunësi/ja në agjencitë e udhëtimit zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, harton planin e menaxhimit të riskut për ruajtjen e sigurisë së klientëve, stafit dhe sigurisë në punë, si dhe garanton standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera. Ai/Ajo planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton rregulloren e brendshme dhe politikat e agjencisë, legjislacionin në fuqi, si dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët.	
97	L6-IV-23	Tregti	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Punonjës shitje	52	Tregtari/ja planifikon dhe organizon punën në njësinë e vet të shërbimit, realizon furnizimet/blerjet e mallrave (të mirave) dhe shërbimeve, realizon procesin e shitjes së mallrave, kryen veprimet në magazinë, pagesa dhe arkëtime, marketingun e mallrave (të mirave) dhe shërbimeve të njësisë së vetë, si dhe blerje dhe shitje online të mallrave (të mirave) dhe shërbimeve. Ai/Ajo krijon dhe administron regjistrin e furnitorëve dhe klientëve, përgatit dhe mirëmban dokumente shkresore, duke përdorur mjete, pajisje apo software dhe programe të ndryshme në funksion të realizimit të veprimtarisë së vet. Tregtari/ja planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton rregulloren e brendshme dhe politikat e organizatës, legjislacionin në fuqi, si dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
98	L7-IV-21	Administrim zyre	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Nëpunës zyre	4110	Asistenti/ja i/e zyrës planifikon dhe organizon punën në zyrë dhe burimet kryesore në përdorim, mirëpret palët e interesuara, administron korrespondencën dhe kalendarin e aktiviteteve, përdor mjetet dhe pajisjet kryesore të zyrës. Ai/Ajo krijon dhe administron bazën e të dhënave, përgatit dhe mirëmban dokumente shkresore, bashkërendon punën për aktivitete specifike. Asistenti/ja i/e zyrës planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
99	L/1-IV-25	Administrim biznesi	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Menaxher i mesëm në biznes	143	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në biznes kryen analizimin, planifikimin dhe organizimin e punës duke planifikuar aktivitetet, burimet njerëzore të nevojshme, burimet e tjera të nevojshme, duke i përzgjedhur ato, duke menaxhuar kohën, ndarë detyrat në ekip dhe duke bashkëpunuar me specialistë ose ekipe të tjera. Ai/Ajo garanton zbatimin e politikave, procedurave të biznesit dhe cilësinë e shërbimeve të biznesit. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në biznes implementon aktivitetet e biznesit dhe burimet njerëzore të biznesit. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në biznes kryen detyra administrative dhe tregtare, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, menaxhon ruajtjen e të dhënave sensitive dhe personale, si dhe siguron ruajtjen e intergritetit. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në biznes zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.	
100	L/2-IV-25	Menaxhim i furnizimit dhe logjistikës	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Menaxher i mesëm i furnizimit dhe logjistikës	1324	Menaxheri/ja i/e mesëm/me i/e furnizimit dhe logjistikës planifikon punën dhe burimet për proceset e logjistikës duke koordinuar punën me ekipin dhe departamentet e tjera. Ai/Ajo menaxhon magazinën dhe inventarin (stokun), menaxhon transportin dhe dërgesat, si dhe llogarit kostot operative të logjistikës. Manaxheri/ja i/e mesëm/me i/e furnizimit dhe logjistikës mbikëqyr mirëmbajtjen e aseteve të logjistikës, administron dokumentacionin tregtar dhe të transportit, përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për automatizim dhe menaxhime operacionale, monitoron treguesit e performancës të proceseve të logjistikës, si dhe mirëmban komunikimin me partnerët e biznesit. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet e duhura për shërbimet e kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushë.	
101	L/3-IV-25	Tregti elektronike (e-commerce)	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Menaxher i mesëm në tregtinë elektronike (e-commerce)	5244.05	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në tregtinë elektronike (e-commerce) planifikon punën dhe burimet duke koordinuar veprimtarinë me ekipin dhe departamentet e tjera. Ai/Ajo menaxhon produktet në platformën online, administron fushatat e marketingut digjital, koordinon proceset e logjistikës (statuset e porosive, procesimin e porosive, stok) etj., analizon dhe raporton të dhënat bazë të proceseve të tregtimit online. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në tregtinë elektronike (e-commerce) menaxhon platformën e-commerce/webshop, optimizon punën për motorët e kërkimit, koordinon shërbimin ndaj klientit, administron pagesat, dokumentacionin financiar, monitoron treguesit e performancës të aktivitetit, si dhe mirëmban komunikimin me partnerët e biznesit. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, përmbush standardet për garantimin e cilësisë, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet e duhura për shërbimet e kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën përkatëse.	

102	L/4-IV-26	Administrim zyre	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Nëpunës zyre	4110	Nëpunësi/ja i/e zyrës kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet dhe pajisjet e punës, duke planifikuar aktivitetet ditore, javore dhe mujore të zyrës, duke planifikuar radhën e punës dhe kohën e realizimit të aktiviteteve, duke kontrolluar funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe duke pastruar dhe sistemuar vendin e punës. Nëpunësi/ja i/e zyrës administron korrespondencën, administron të dhënat dhe bazën e të dhënave dhe menaxhon dokumentacionin. Ai/Ajo menaxhon logjistikën e zyrës së eprorit dhe aggjendën e eprorit/institucionale. Nëpunësi/ja i/e zyrës bashkërendon/koordinon veprimtari të veçanta, duke përfshirë organizimin e aktiviteteve, menaxhimin e pjesëmarrësve dhe monitorimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve. Nëpunësi/ja i/e zyrës komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Nëpunësi/ja i/e zyrës ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
103	L1-V-22	Ndërmjetësimi i pasurive të paluajtshme	Programe pas të mesëm 2 vjeçare	Menaxherë dhe aggjentë të pasurive të patundshme	3334	Ndërmjetësuesi/ja i/e pasurive të paluajtshme planifikon dhe organizon punën në zyrë dhe burimet kryesore në përdorim, kërkon në treg për pasuri dhe klientë, analizon tregun e pasurive të paluajtshme dhe promovon pasuritë, veten dhe zyrën e ndërmjetësimit. Ai/Ajo këshillon klientët dhe negocion me ta për tregun, ndërmjetëson klientët dhe transaksioninn, si dhe lehtëson procesin e përfitimit të shërbimeve të lidhura me to, për klientët e vet. Ai/Ajo krijon dhe administron regjistrin e klientëve dhe pasurive për transaksion, bazën e të dhënave, përgatit dhe mirëmban dokumente shkresore duke përdorur mjete, pajisje apo aplikacione të ndryshme në funksion të realizimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit. Ndërmjetësuesi/ja i/e pasurive të paluajtshme planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, zbaton rregulloren e brendshme dhe politikat e organizatës, legjislacionin në fuqi, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
104	M-II-25	Shërbime mjetesh transporti	Program 2-vjeçar studimi për punonjës gjysëm i kualifikuar (ndihmës)	Riparues automjeti	7231.17	Ndihmësi/ja në autoservis organizon punën duke zbërthyer urdhrin e punës, lexuar librin e shërbimit të mjeteve të transportit, duke përgatitur mjetin e transportit për shërbim, duke planifikuar mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, si dhe duke përcaktuar radhën e punës për realizimin e detyrës. Ndihmësi/ja në autoservis kryen punime të thjeshta riparimi në motor, në sistemin e thithjes dhe shkarkimit të gazrave, në sistemin e transmetimit të fuqisë, sistemin e frenimit, në sistemin e drejtimit, në sistemin e varjes dhe të ecjes të mjeteve të transportit, në sistemet elektrike dhe elektronike, si dhe në sistemet ndihmëse. Ndihmësi/ja në autoservis bashkëpunon me eprorët dhe kolegët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe duke respektuar parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe ngre nivelin profesional në mënyrë të vazhdueshme.	
105	M1-III-22	Shërbime motori	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Motorist	7231.16	Motoristi/ja parapërgatit dhe organizon vendin e punës, kryen kontrollet paraprake të motorit, kryen punime në pjesët e palëvizshme dhe në mekanizmat e motorit. Ai/Ajo kryen punime në sistemin e ftohjes së motorit, sistemin e vajosjes, sistemin e ushqimit, në sistemin e shkarkimit të gazrave dhe furnizimin me ajër me presion, si dhe në sistemin elektrik të motorit. Ai/ajo përzgjedh veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në motorët e mjeteve të transportit, si dhe realizon kontrolle dhe matje në to. Ai/Ajo realizon identifikimin e parregullsive në motorët e mjeteve të transportit, punime të mirëmbajtjes dhe riparime apo zëvendësime. Motoristi/ja kryen detyra administrative dhe tregtare, interpreton dhe plotëson dokumentacionin teknik për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në motorët e mjeteve të transportit. Ai/Ajo diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera, në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo gjatë kryerjes së punimeve, respekton me përpikëri rregullat e sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinerive, pajisjeve dhe materialeve, respekton standardet e sigurisë, manualet përkatëse të mjeteve të transportit, makinerive, pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe legjislacioninë në fuqi, për të garantuar cilësinë e shërbimeve të kryera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologji të reja për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në motorët e mjeteve të transportit.	
106	M2-III-22	Shërbime xhenerike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Xhenerik	7231.24	Xheneriku/ja interpreton dhe plotëson dokumentacionin teknik për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët xhenerike të mjeteve të transportit dhe organizon vendin e punës. Ai/Ajo përzgjedh veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët xhenerike të mjeteve të transportit dhe realizon kontrolle dhe matje në to. Ai/Ajo realizon diagnostikimin e parregullsive në pjesët xhenerike të mjeteve të transportit. Ai/Ajo realizon punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në mekanizmat dhe sistemet e automjetit, duke zbatuar standardet e profesionit. Xheneriku/ja diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera, në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo gjatë kryerjes së punimeve, respekton me përpikmëri rregullat e sigurisë në përdorimin e makinerive, pajisjeve dhe materialeve. Ai/Ajo kryen proceset e punës në mënyrë korrekte, duke respektuar standardet e sigurisë, indikacionet e prodhuesve dhe ligjet përkatëse, për të siguruar punë të saktë dhe garantuar sigurinë maksimale. Ai/Ajo plotëson dokumentacionin financiar, zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe përditësuar me teknologjitë e reja për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët xhenerike të mjeteve të transportit.	
107	M3-III-22	Shërbime elektro-auto	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Elektroaut për automjete	7231.03	Elektroauti/ja organizon vendin e punës, përzgjedh veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit dhe realizon kontrolle dhe matje në to. Ai/Ajo kryen kontrolle për identifikimin e parregullsive në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit. Ai/Ajo realizon punime të mirëmbajtjes dhe riparimit, interpreton dhe plotëson dokumentacionin teknik për shërbimet e kryera duke zbatuar standardet e profesionit. Ai/Ajo gjatë kryerjes së punimeve, zbaton dhe respekton, me përpikëri, rregullat e sigurisë në përdorimin e makinerive, pajisjeve dhe materialeve, legjislacionin e fushës në fuqi, garanton cilësinë për shërbimet e kryera, plotëson dokumentacionin financiar, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë së shëndetit në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Elektroauti/ja diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit.	
108	M4-III-23	Shërbime karrocerie	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës për shërbime karrocerie	7231.25	Punonjësi/ja specialist/e për shërbime karrocerie kryen kontrollin paraprak të mjetit, punime në shasi, punime në kabinë, në elementet e çmontueshme të kabinës, si dhe në pjesët e brendshme të kabinës duke përdorur mjetet, veglat, pjesët e këmbimit dhe pajisjet e duhura. Ai/Ajo kryen procese stukimi, zmerilimi, lyerje dhe luçidimi. Përpara fillimit të punimeve, ai/ajo planifikon dhe organizon punën, duke përzgjedhur bazën materiale, pajisjet e punës, mjetet apo makineritë e duhura sipas proceseve të punës. Ai/Ajo përgatit veglat, mjetet, pajisjet e punës, materialet, pjesët e këmbimit dhe vendin e punës, si dhe kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës. Punonjësi/ja specialist/e për shërbime karrocerie bashkëpunon me specialistë të tjerë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit.	
109	M5-III-16	Shërbime mjetesh të rënda transporti	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Teknikë të shërbimeve të mirëmbajtjes për mjete të rënda	7233.31		Mekaniku/ja, montuesi/ja, riparuesi/ja i/e makinave bujqësore dhe industriale përshtat, instalon, bën testime apo diagnostikime për defektet, kryen shërbime, si dhe riparon dhe zëvendëson pjesët e dëmtuara të motorëve dhe pajisjeve mekanike të makinerive bujqësore, industriale dhe anijeve, me përjashtim të mjeteve motorike, avionëve dhe motorëve elektrikë. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të shërbimeve, riparimeve apo shitjeve të makinave bujqësore dhe industriale.
110	M6-III-16	Mekanikë bujqësore	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Mekanik për makineri bujqësore	7233.03		Mekaniku/ja, montuesi/ja, riparuesi/ja i/e makinave bujqësore dhe industriale përshtat, instalon, bën testime apo diagnostikime për defektet, kryen shërbime, si dhe riparon dhe zëvendëson pjesët e dëmtuara të motorëve dhe pajisjeve mekanike të makinerive bujqësore, industriale dhe anijeve, me përjashtim të mjeteve motorike, avionëve dhe motorëve elektrikë. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të shërbimeve, riparimeve apo shitjeve të makinave bujqësore dhe industriale.
111	M8-III-26	Mekanikë bujqësore	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Mekanik për makineri bujqësore	7233.03	Mekaniku/ja për makineri bujqësore kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke analizuar dokumentacionin teknik, duke planifikuar proceset e punës, si dhe duke përcaktuar radhën dhe kohën e punës. Ai/Ajo planifikon dhe përzgjedh mjetet, instrumentet matëse, instrumentet kontrolluese, veglat, materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit, kryen pastrimin dhe sistemimin e veglave dhe vendit të punës, bashkëpunon me të tjerët, si dhe raporton për punën e kryer. Mekaniku/ja për makineri bujqësore kryen kontrolle të sistemeve në makineritë bujqësore për të identifikuar parregullsitë në sistemet e makinerive. Ai/Ajo kryen punime në sistemet e motorit dhe të kondicionimit të ajrit të makinerive bujqësore, në sistemin e transmetimit të fuqisë së makinerive, në sistemin e drejtimit, të frenimit, të varjes dhe të ecjes së makinerive bujqësore, në sistemin e komandimit hidraulik dhe pneumatik të makinerive bujqësore, në sistemet elektrike dhe elektronike në makineritë bujqësore dhe në pajisjet ndihmëse të makinerive bujqësore. Mekaniku/ja për makineri bujqësore kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Mekaniku/ja për makineri bujqësore ngre nivelin profesional duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
112	M7-IV-20	Shërbime mekatronike në automjet	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Teknikë automjeti për shërbimet mekatronike	7231.2		Riparuesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e automjeteve bën kontrollin, diagnostikimin e automjeteve për të lokalizuar defektet, riparimin, si dhe shërbime të ndryshme në sistemet dhe elementët mekanikë, elektrikë, elektronikë dhe hidraulikë të tyre. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani automjetesh, në reparte autoservisi, në shoqëri transporti dhe tregtare që kanë reparte të shërbimit dhe riparimit të automjeteve, në qendra të kontrollit teknik të automjeteve apo të vetëpunësohet.
113	M-IV-23	Shërbime mjetesh transporti	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknik/inxhinieri mekanike (automjete)	3115.13	Tekniku/ja i/e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve analizon dhe organizon punën duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës, materialet dhe pjesët e këmbimit, si dhe duke përcaktuar radhën e punës dhe kohëzgjatjen. Ai/Ajo identifikon parregullsitë në mjet, ndjek proceset për riparim dhe mirëmbajtje, kontrollon cilësinë e punimeve përfundimtare dhe ndjek mirëmbajtjen e servisit. Tekniku/ja i/e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve përpilon dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mjetit, dokumentacionin paraprak të riparimit, dokumentacionin e kontrollit të cilësisë dhe dokumentacionin për garancinë e punimeve të kryera. Ai/Ajo llogarit koston dhe kohën e shërbimit/riparimit, përgatit faturat për shërbimet e kryera, përgatit raporte periodike të punës për aktivitetet e zbatuara, si dhe plotëson regjistrin themeltar të riparimit dhe librin personal të shërbimeve të mjetit. Tekniku/ja i/e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve bashkëpunon me specialistë të tjerë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	

114	M/1-IV-26	Riparime dhe mirëmbajtje automjetesh	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Riparues dhe mirëmbajtës të automjeteve	7231	Riparuesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e automjeteve planifikon dhe organizon vendin e punës dhe veprimtarinë e vet, kryen kontrolle, matje dhe testime në automjet për të përcaktuar defektet e mundshme, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura apo programet diagnostikuese përkatëse. Ai/Ajo kryen mirëmbajtjet periodike, punime elektrike dhe elektronike, punime në sistemet e drejtimit, amortizimit, frenimit, në sistemin e transmetimit të lëvizjes, në sistemin e prodhimit (motor) dhe transmetimit të fuqisë, në sistemin AC dhe në sistemin e sigurisë duke u konsultuar me teknikët dhe specialistët e tjerë. Riparuesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e automjeteve kryen detyra administrative dhe tregtare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së punimeve të kryera.	
115	M/2-IV-26	Shërbime në automjete elektrike dhe hibride	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Riparues dhe mirëmbajtës i automjeteve elektrike dhe hibride	7231	Riparuesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e automjeteve elektrike dhe hibride planifikon dhe organizon punën në një autoservis për shërbime, pranon automjetin elektrik apo hibrid (EV dhe HEV) për kryerjen e shërbimeve, diagnostikon automjetin për defekte të mundshme duke përdorur mjetet, pajisjet dhe programet e duhura. Ai/Ajo parapërgatit automjetin dhe mjedisin e punës për punime mirëmbajtje dhe riparime, kryen punime elektrike, elektronike, mekatronike, mekanike dhe mirëmbajtje në automjete EV dhe HEV, duke zbatuar me korrektësi rregullat dhe standardet teknike të sigurisë për kryerjen e punime në këto automjete. Riparuesi/ja dhe mirëmbajtësi/ja i/e automjeteve elektrike dhe hibride kryen detyra administrative dhe tregtare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë të shërbimeve të kryera.	
116	M1-V-23	Diagnostikim-menaxhim në autoservis	Programe pas të mesëm 1 vjeçar	Specialist për diagnostikim dhe menaxhim autoservisi	3115		Tekniku/ja i/e inxhinierisë mekanike kryen detyra teknike për të ndihmuar inxhinierët në kërkime të inxhinierisë mekanike, në projektime, prodhime, montime, ndërtime, operime, në eliminimin e defekteve, mirëmbajtje dhe riparim të makinave, komponentëve të tyre, pajisjeve mekanike, makinerive dhe pajisjeve në sistemet industriale të uzinave e fabrikave, nën mbikëqyrjen e inxhinierëve. Aktiviteti i teknikut/es të inxhinierisë mekanike shtrihet në shumë drejtime: a) Konceptimi dhe vënia në zbatim e produktit për teknikun e studimit; b) Menaxhimi i prodhimit për teknikun e linjës; c) Verifikimi i cilësisë së produktit për teknikun e kontrollit te cilësisë; d) Mirëmbajtja e pajisjeve teknike për teknikun e mirëmbajtjes dhe e) Studimi i tregut dhe komercializimi i produktit për teknikun tekno-komercial. Tekniku/ja i/e inxhinierisë mekanike punësohet në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve të industrisë mekanike ose vetëpunësohet.
117	M2-V-20	Mekatronikë automjetesh	Programe pas të mesëm 2 vjet	Specialist i mekatronikës në automjete	3115	Tekniku/ja për shërbimet mekatronike në automjet është në gjendje të kuptojë nevojat e klientit, të diagnostikojë dhe të planifikojë ndërhyrjet e nevojshme dhe të operojë në pjesët elektrike, elektronike, kompjuterike dhe mekanike të automjetit, në përputhje me ato që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë mekatronike në riparimin e makinave. Ai/Ajo interpreton dokumentacionit teknik, harton dhe zbaton planet e punës, kryen punime diagnostikuese me pajisje, mjete, instrumente dhe testues kompjuterikë, verifikon funksionalitetin e përbërësve elektrik, elektronik dhe kompjuterik të sistemeve të automjetit, si dhe kryen punime riparimi. Me kërkesë të klientëve, ai/ajomund të instalojë sisteme dhe pajisje shtesë. Ai/Ajo respekton me përpikëri rregullat e sigurisë në përdorimin e makinerive, pajisjeve dhe materialeve gjatë kryerjes së punimeve. Ai/Ajo respekton standardet e sigurisë dhe indikacionet e prodhuesve, si dhe zbaton ligjet, për të siguruar punë të saktë dhe garantuar sigurinë maksimale.	
118	M3-V-25	Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit	Program, pas të mesme 1-vjeçar studimi	Teknik automjeti për shërbimet mekatronike	7231.20	Tekniku/ja i/e mekatronikës së kamioneve diagnostikon, mban, shërben dhe riparon sistemet mekanike, elektrike, elektronike, hidraulike, pneumatike, pajisjet dhe skajet e tjera të automjetit. Teknik/e i/mekatronikës së kamioneve planifikon aktivitete, përgatit burimet e nevojshme dhe hapësirën për kryerjen e punëve, realizon pranimin e automjetit, vendos diagnozën duke përdorur metoda dhe pajisje moderne, duke përdorur dokumentacionin teknik dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit. Ai/Ajo kryen kontrollin, rregullimin, riparimin, zëvendësimin dhe mbikëqyrjen e punimeve të sistemeve mekanike, hidraulike, pneumatike, elektrike dhe elektronike/pajisjeve/pjesëve dhe pajisjeve shtesë në automjet ose, sipas nevojës, i dërgon ato specialistëve. Teknik/e i/mekatronikës së kamioneve mban dokumentacionin e punës dhe kryen punë administrative dhe komerciale nga fusha e punës së tij/saj. Ai/Ajo komunikon me eprorët, bashkëpunëtorët dhe përdoruesit e shërbimeve (diskuton dhe propozon mundësitë për zgjidhje sipas kërkesave) duke përdorur rregullat e komunikimit etik dhe profesional. Ai/Ajo përdor dhe siguron standardet e cilësisë, zbaton procedurat dhe masat për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton masat për mbrojtje nga zjarri. Teknik/e i/mekatronikës së kamioneve gjatë kryerjes së detyrave të punës përdor teknologjitë moderne, pajisje/instrumente për matjen e të gjitha madhësive që është e nevojshme të përcaktohen, si dhe mjetet dhe pajisjet e duhura sipas udhëzimeve të prodhuesit.	
119	N-IV-25	Veterinari	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Teknik/Menaxher i mesëm në veterinari	3240	Tekniku/ja veteriner/e kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, duke përcaktuar prioritetet e ditës, duke përgatitur vendin e punës dhe duke bashkëpunuar me specialistë të tjerë. Ai/Ajo ndjek profilaksinë, kontrollon higjienën dhe shëndetin e kafshëve, kujdeset për shëndetin riprodhues, kujdeset për të ushqyerit e kafshëve dhe kryen kirurgjinë profilaktike me procedura kirurgjikale. Tekniku/ja veteriner/e administron preparatet mjekësore veterinare sipas udhëzimit të mjekut veteriner, si dhe mbledh kampionet për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor duke zbatuar procedurat e paracaktuara. Tekniku/ja veteriner/e kryen detyra administrative dhe tregtare, dokumenton punën e kryer, si dhe administron regjistrin, kartelat mjekësore dhe dokumentacionin veterinar. Ai/ Ajo raporton tek eprori, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së shërbimeve të kryera.	
120	O-II-22	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës ndihmës të kujdesit personal	53	Punonjësi/ja ndihmës/e ofron shërbim për të gjitha grupet vulnerabël në fushën e shërbimeve social-shëndetësore në përputhje me standardet që përcaktojnë ofrimin e tyre. Ai/Ajo organizon punën e përditshme, ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, në plotësimin e nevojave jetike, në plotësimin e nevojave social-shëndetësore, edukative dhe argëtuese, si dhe ndihmon në ruajtjen e marrëdhënieve familjare ose shoqërore të përfituesit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore. Punonjësi/ja ndihmës/e garanton që përfituesit të marrin shërbimet e nevojshme, përfshirë edhe ato të jetës së përditshme (ushqim, veshmbathje, akomodim, etj.), siguron realizimin e aktiviteteve të ndryshme, punon dhe bashkërendon punën me një ekip ndërdisiplinor (mjekë, infermierë, psikologë, sociologë, edukatorë, etj.). Punonjësi/ja ndihmës/e udhëhiqet nga parimet e ofrimit të shërbimeve për njerëzit në nevojë, pa dallim feje, gjinie, race, kombësie, moshe, statusi social, ekonomik dhe shëndetësor etj. Punonjësi/ja ndihmës/e komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët, përfituesit dhe palët e tjera më të cilët bashkëpunon. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së shërbimeve social- shëndetësore.	
121	O1-III-24	Shërbime kujdesi për të moshuar	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të kujdesit personal për të moshuar	5323	Punonjësi/ja i/e kujdesit personal për të moshuar kryen organizimin e punës duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet, pajisjet e punës dhe burimet njerëzore, duke ndarë detyrat në ekip dhe duke bashkëpunuar me specialistë të tjerë në zbatim të agjendës ditore. Punonjësi/ja i/e kujdesit personal për të moshuar ndihmon në përmbushjen e nevojave bazike, pëkujdeset për plotësimin e nevojave shëndetësore, përkujdeset për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme argëtuese, bashkëpunon me familjen/të afërmit e të moshuarit, duke zbatuar me rigorozitet politikat e mbrojtjes sociale mbi moshimin. Punonjësi/ja i/e kujdesit personal për të moshuar kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton dhe raporton vazhdimisht për punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët, të moshuarit dhe familjen/të afërmit, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e higjienës personale dhe vendit të punës, rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin në fuqi për fushën ku ushtron veprimtarinë. Ai/ajo angazhohet të rrisë kapacitetet profesionale duke marrë pjesë në trajnime dhe duke u përditësuar me zhvillimet e reja të fushës.	
122	O2-III-24	Shërbime kujdesi për fëmijë	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të kujdesit për fëmijë	5311	Punonjësi/ja i/e kujdesit për fëmijë kryen organizimin e punës duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, materialet, pajisjet e punës dhe burimet njerëzore, duke ndarë detyrat në ekip dhe duke bashkëpunuar me specialistë të tjerë në zbatim të agjendës ditore. Punonjësi/ja i/e kujdesit për fëmijë siguron plotësimin e nevojave bazike të fëmijës, organizon aktivitete të ndryshme edukative, organizon aktivitete socio-argëtuese, përkujdeset për shëndetin e fëmijës dhe siguron mjedis të sigurt për fëmijën, duke zbatuar me rigorozitet politikat e mbrojtjes së fëmijëve. Punonjësi/ja i/e kujdesit për fëmijë kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton dhe raporton vazhdimisht për punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe prindërit/kujdestarët ligjorë, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e higjienës personale dhe vendit të punës, rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin në fuqi për fushën ku ushtron veprimtarinë. Ai/Ajo angazhohet të rrisë kapacitetet profesionale duke marrë pjesë në trajnime dhe duke u përditësuar me zhvillimet e reja të fushës.	
123	O3-III-16	Animacion social	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Animator social	2659.08		Artistët dhe krijuesit e tjerë kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Performojnë sjellje të çuditshme zbavitëse dhe tregojnë histori gazmore; b) Përformojnë truke iluzionesh apo lojëra me duart dhe bëma me hipnotizëm; c) Performojnë akrobacira të vështira, spektakolare, gjimnastikë apo lojëra shpejtësie; d) Trajnojnë dhe performojnë me kafshët; e) Përcaktojnë rrethin e veprimeve/numrave/akrobacive që do të realizojnë gjatë shfaqjeve; f) Bashkëpunojnë më artistë të tjerë më qëllim arritjen e rezultateve sa më të mira; dhe g) Përzgjedhin, pranojnë, trajnojnë dhe vlerësojnë personelin me të cilin punojnë.
124	O4-III-16	Shërbime sociale	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës social	3412.1		Asistentët, specialistët e punës sociale ofrojnë udhëzime klientëve për çështje sociale, punë administrative duke zbatuar programe të asistencës sociale dhe shërbimeve ndaj komunitetin. Ata asistojnë dhe këshillojnë klientët për të identifikuar qasjet e tyre në burimet e komunitetit për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë ndihmën ligjore, mjekësore, financiare, strehim, punësim, transport, ndihmë me lëvizje, kujdesi ditor dhe shërbime të tjera. Ata mund të punësohet në institucione apo kompani shërbimesh sociale dhe shëndetësore ose të vetëpunësohet.
125	O-IV-25	Shërbime sociale dhe shëndetësore	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Menaxher i mesëm në ofrimin e shërbimeve social - shëndetësore	3112	Menaxheri/ja i/e mesëm/me në ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore është ndërmjetësues i hierarkisë organizative mes drejtuesve të lartë dhe stafit që ofron shërbim direkt. Ai/Ajo është përgjegjës/e për menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të institucionit, përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, kohore dhe materiale, me qëllim që përfituesit të marrin shërbime cilësore, në përputhje me nevojat e tyre dhe me standardet për ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke planifikuar dhe përzgjedhur burimet njerëzore, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, duke përcaktuar prioritetet e punës, radhën e punës dhe afatet kohore, si dhe duke vlerësuar planin periodik të veprimit. Ai/Ajo kryen identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, koordinon shërbimet, mbikëqyr shërbimet dhe garanton cilësinë e shërbimeve. Menaxheri/ja i/e mesëm/me në ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore kryen detyra administrative dhe tregtare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, me eprorët, kolegët, stafin dhe përfituesit e shërbimit, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.	

126	O1-V-23	Parukeri e avancuar	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Parukierë	5141		Parukieri, berberi kryen larje të kokës, lyerje me bojë flokësh, prerje, krehje dhe stilim të flokëve, rruajtje dhe shkurtim të mjekrës apo mustaqeve. Ai/Ajo kryen trajtim të flokëve dhe ofron këshilla për kujdesin e flokëve dhe për produktet e bukurisë. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani shërbimesh parukerie, apo të vetëpunësohet.
127	O2-V-23	Estetikë e avancuar	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Kozmetologë dhe profesione që lidhen me të	5142		Kozmetologë dhe profesione që lidhen me to kujdesen për pamjen e jashtme të klientëve, bëjnë trajtime të fytyrës dhe të trupit të individit, si edhe trajtime të tjera me qëllim përmirësimin e paraqitjes së tyre. Kozmetologët dhe profesione që lidhen me të kryejnë një pjesë ose tërësinë e detyrave të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Pastrojnë fytyrën dhe pjesë të trupit duke përdorur kremëra, locione dhe produkte të ngjashme; b) Bëjnë mesazh fytyrës dhe trupit të klientit; c) Pyesin dhe vlerësojnë kërkesat e klientëve; d) Trajtojnë paraqitjen e jashtme të klientëve; e) Bëjnë punime kozmetike me produktet që disponojnë; f) Rregullojnë thonjtë e dorës dhe të këmbës sipas porosisë së klientit; g) Kujdesen për klientët për banjë të trupit duke bërë masazh të thjeshtë; h) Përdorin teknikat e punimit me dyllë dhe depilojnë qimet e padëshiruara; i) Aplikojnë manikyrin dhe pedikyrin sipas dëshirës së klientëve; j) Këshillojnë klientët mbi dietat dhe ushtrimet fizike për ulje në peshë; k) Organizojnë takime dhe mbledhin paratë që paguhen për shërbimin e kryer; l) Zbatojnë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe m) Zbatojnë rregullat e etikës në vendin e punës.
128	O3-V-23	Masazheri estetiko kuruese	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Terapist masazh	3255.12		Asistenti/ja dhe tekniku/ja i/e fizioterapisë kryen shërbime dhe trajtime fizioterapie për pacientët të cilët kanë pësuar dëmtime në gjymtyrët e lëvizshëm ose kur këto gjymtyrë kërcënohen nga ndonjë sëmundje apo çrregullim i mundshëm. Ai/Ajo zbaton planin e terapisë të përcaktuar nga mjeku fiziatër. Ai/Ajo mund të punësohet në spital shtetëror ose privat, në klinika private dhe qendra estetike.
129	O4-V-23	Fizioterapi estetike	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Asistent fizioterapeut	3255.01		Asistenti/ja dhe tekniku/ja i/e fizioterapisë kryen shërbime dhe trajtime fizioterapie për pacientët të cilët kanë pësuar dëmtime në gjymtyrët e lëvizshëm ose kur këto gjymtyrë kërcënohen nga ndonjë sëmundje apo çrregullim i mundshëm. Ai/Ajo zbaton planin e terapisë të përcaktuar nga mjeku fiziatër. Ai/Ajo mund të punësohet në spital shtetëror ose privat, në klinika private dhe qendra estetike.
130	O5-V-25	Shërbime punësimi	Program, pas të mesme 1-vjeçar studimi	Specialist i shërbimeve të punësimit	3333.04	Specialisti/ja i/e shërbimeve të punësimit planifikon shërbimet që do të ofrojë, radhën e punës dhe prioritetet e ditës, harton planin mujor të punës dhe organizon punën për ofrimin e shërbimeve të punësimit. Ai/Ajo kryen procesin e regjistrimit të punëkërkuesit/punëdhënësit, kryen procesin e ndërmjetësimit, si dhe procesin e këshillimit dhe orientimit të punëkërkuesve. Specialisti/ja i/e shërbimeve të punësimit bashkëpunon me specialistë të tjerë dhe me institucione të tjera partnere duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe duke respektuar parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Specialisti/ja i/e shërbimeve të punësimit kryen detyra administrative dhe tregtare, dokumenton punën e kryer dhe raporton mbi realizimet e kryera. Ai/Ajo ngre vazhdimisht nivelin profesional të vetes, si dhe zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
131	P-II-16	Poligrafi	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës të fushës së shtypshkrimit	734		Punonjës të fushës së shtypshkrimit/printimit përcaktojnë pajisjen para së të fillojnë printimin, përgatisin dhe vendosin në punë thikat, lidhin dhe përfundojnë produktet e mbaruara, përgatisin shabllonet dhe vendosin në punë pajisjet e printimit.
132	Q-II-17	Teknologji kimike	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës në teknologjinë kimike	813		Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që përpunojnë kimikate të ndryshme dhe përbërës të tjerë në prodhimin e farmaceutikës, produktet e tualetit dhe higjienës, lëndëve plasëse dhe fotografike ose produkte të tjera kimike. Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Organizojnë proceset e punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; b) Monitorojnë makineri të përzierjes, paketimit ose përpunimit të kimikateve dhe produkteve kimike për t'u dhënë atyre vetitë e dëshiruara për prodhim të mëtejshëm industrial ose për të bërë produkte përfundimtare; c) Përgatisin makineritë dhe pajisjet për proceset e duhura të punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; d) Monitorojnë dhe drejtojnë funksionimin makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; e) Verifikojnë dhe monitorojnë mirëfunksionim e makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të punës; f) Testojnë dhe analizojnë mostrat të produkteve të prodhuara; g) Mbajnë të dhëna dhe regjistrojnë funksionimin e makinerive; h) Kryejnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e makinerive, pajisjeve dhe ambienteve, sipas procedurave të paracaktuara, në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; i) Zbatojnë rregullat sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
133	Q1-III-19	Teknologji e përpunimit të naftës	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të përpunimit të naftës dhe gazit	813		Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që përpunojnë kimikate të ndryshme dhe përbërës të tjerë në prodhimin e farmaceutikës, produktet e tualetit dhe higjienës, lëndëve plasëse dhe fotografike ose produkte të tjera kimike. Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Organizojnë proceset e punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; b) Monitorojnë makineri të përzierjes, paketimit ose përpunimit të kimikateve dhe produkteve kimike për t'u dhënë atyre vetitë e dëshiruara për prodhim të mëtejshëm industrial ose për të bërë produkte përfundimtare; c) Përgatisin makineritë dhe pajisjet për proceset e duhura të punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; d) Monitorojnë dhe drejtojnë funksionimin makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; e) Verifikojnë dhe monitorojnë mirëfunksionim e makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të punës; f) Testojnë dhe analizojnë mostrat të produkteve të prodhuara; g) Mbajnë të dhëna dhe regjistrojnë funksionimin e makinerive; h) Kryejnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e makinerive, pajisjeve dhe ambienteve, sipas procedurave të paracaktuara, në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; i) Zbatojnë rregullat sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
134	Q2-III-15	Teknologji e prodhimit të materialeve të ndërtimit	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor të prodhimit të çimentos, gurëve dhe materialeve të tjera	813		Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që përpunojnë kimikate të ndryshme dhe përbërës të tjerë në prodhimin e farmaceutikës, produktet e tualetit dhe higjienës, lëndëve plasëse dhe fotografike ose produkte të tjera kimike. Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Organizojnë proceset e punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; b) Monitorojnë makineri të përzierjes, paketimit ose përpunimit të kimikateve dhe produkteve kimike për t'u dhënë atyre vetitë e dëshiruara për prodhim të mëtejshëm industrial ose për të bërë produkte përfundimtare; c) Përgatisin makineritë dhe pajisjet për proceset e duhura të punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; d) Monitorojnë dhe drejtojnë funksionimin makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; e) Verifikojnë dhe monitorojnë mirëfunksionim e makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të punës; f) Testojnë dhe analizojnë mostrat të produkteve të prodhuara; g) Mbajnë të dhëna dhe regjistrojnë funksionimin e makinerive; h) Kryejnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e makinerive, pajisjeve dhe ambienteve, sipas procedurave të paracaktuara, në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; i) Zbatojnë rregullat sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
135	Q3-III-16	Teknologji e përpunimit të plastikës dhe gomës	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë të makinerive për produkte të gomës dhe plastikës	8141		Punonjës të makinerive të prodhimit të produkteve të gomës dhe plastikës drejtojnë dhe monitorojnë makinat që bluajnë dhe përziejnë gomën dhe përbërësit e gomës dhe prodhojnë elementë të ndryshëm, produkte nga goma natyrale dhe sintetike, siç janë forma e këpucëve, artikuj shtëpiakë, materiale izoluese, aksesorë industrialë ose goma makinash.

136	Q4-III-15	Teknologji e prodhimit të bojërave	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës të prodhimit të bojrave	813		Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që përpunojnë kimikate të ndryshme dhe përbërës të tjerë në prodhimin e farmaceutikës, produktet e tualetit dhe higjienës, lëndëve plasëse dhe fotografike ose produkte të tjera kimike. Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Organizojnë proceset e punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; b) Monitorojnë makineri të përzierjes, paketimit ose përpunimit të kimikateve dhe produkteve kimike për t'u dhënë atyre vetitë e dëshiruara për prodhim të mëtejshëm industrial ose për të bërë produkte përfundimtare; c) Përgatisin makineritë dhe pajisjet për proceset e duhura të punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; d) Monitorojnë dhe drejtojnë funksionimin makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; e) Verifikojnë dhe monitorojnë mirëfunksionim e makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të punës; f) Testojnë dhe analizojnë mostrat të produkteve të prodhuara; g) Mbajnë të dhëna dhe regjistrojnë funksionimin e makinerive; h) Kryejnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e makinerive, pajisjeve dhe ambienteve, sipas procedurave të paracaktuara, në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; i) Zbatojnë rregullat sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
137	Q-IV-16	Teknologji kimike	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknolog industrial	813		Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike drejtojnë dhe monitorojnë makineritë që përpunojnë kimikate të ndryshme dhe përbërës të tjerë në prodhimin e farmaceutikës, produktet e tualetit dhe higjienës, lëndëve plasëse dhe fotografike ose produkte të tjera kimike. Punonjës të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Organizojnë proceset e punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; b) Monitorojnë makineri të përzierjes, paketimit ose përpunimit të kimikateve dhe produkteve kimike për t'u dhënë atyre vetitë e dëshiruara për prodhim të mëtejshëm industrial ose për të bërë produkte përfundimtare; c) Përgatisin makineritë dhe pajisjet për proceset e duhura të punës në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; d) Monitorojnë dhe drejtojnë funksionimin makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; e) Verifikojnë dhe monitorojnë mirëfunksionim e makinerive dhe pajisjeve gjatë proceseve të punës; f) Testojnë dhe analizojnë mostrat të produkteve të prodhuara; g) Mbajnë të dhëna dhe regjistrojnë funksionimin e makinerive; h) Kryejnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e makinerive, pajisjeve dhe ambienteve, sipas procedurave të paracaktuara, në uzina të prodhimeve kimike dhe makinerive të produkteve fotografike; i) Zbatojnë rregullat sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
138	R-IV-22	Gjeodezi	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Teknik topograf	3112.17	Tekniku/ja gjeodet/e kryen parapërgatitjet e duhura për punë duke përzgjedhur materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet e duhura. Ai/Ajo kryen rilevim të terrenit, piketime në terren sipas teknikave dhe metodologjive përkatëse. Tekniku/ja gjeodet/e regjistron saktë të dhënat sipas formateve të paracaktuar dhe përpunon informacion e marrë në terren duke përdorur programe software-ike përkatëse. Ai/Ajo përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Tekniku/ja gjeodet/e analizon, planifikon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë.	
139	S-II-22	Pyje	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtorë pyjesh	9215	Punëtori/ja i/e pyjeve kryen punime pyllëzimi duke grumbulluar fara pyjore, duke përgatitur tokën për mbjellje e farave dhe fidanëve dhe duke kryer shërbime pas mbjelljes së fidanëve. Ai/Ajo kryen shërbime silvikulturore, shërbime për mbrojtjen e pyjeve, punime për shfrytëzimin e pyjeve. Punëtori/ja i/e pyjeve mbledh produkte jo drusore, kujdeset për mbarështimin e faunës pyjore, ndihmon gjatë procesit të matjes dhe mbarështimit të pyjeve, kryen punime për mbarështimin e kullotave dhe punime ndërtimore në pyje/ kullota. Punëtori/ja i/e pyjeve bashkëpunon me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë në punimet që kryen.	
140	S1-IV-24	Silvikulturë	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik silvikulturë (drurët)	3142.03	Tekniku/ja i/e silvikulturës analizon, planifikon dhe organizon punën për të zbatuar projektin/preventivin. Në këtë kuadër ai/ajo planifikon veprimtarinë mujore të punës, planifikon dhe përzgjedh burimet njerëzore, mjetet, bazën materiale, pajisjet e punës, planifikon kohën e punës, ndan detyrat në ekip, si dhe bashkëpunon me specialistë të tjerë. Tekniku/ja silvikulturë mbikëqyr punimet (zbatimin e masave) silvikulturale në pyll, mbikëqyr procesin e prodhimit të materialit mbjellës, kryen inventarizimin dhe mbarështimin në pyje, kullota dhe prodhime pyjore jo-drusore (PPJD), zbaton projektet për mbarështimin e faunës, si dhe zbaton projektet e pyllëzimit. Ai/Ajo kryen procesin e monitorim-vlerësimit të gjendjes së pyjeve, kullotave dhe bimëve mjekësore-eterovajore duke kontrolluar dhe grumbulluar të dhëna në zbatim të programit të monitorimit të pyjeve, kullotave dhe PPJD dhe Fondit Pyjor, Kullosor për përditësimin e të dhënave të Kadastrës. Tekniku/ja silvikulturë kryen detyra administrative dhe tregtare, si dhe raporton tek eprorët mbi realizimet apo problematikat gjatë punës. Ai/Ajo diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Tekniku/ja silvikulturë zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat për parandalimin, mbrojtjen ndaj zjarrit dhe shpëtimin, zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve/shërbimeve të kryera. Ai/Ajo ngre nivelin e tij/saj profesional duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e pyjeve, kullotave dhe bimëve mjekësore etero-vajore.	
141	S2-IV-18	Shfrytëzim pyjesh	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik pyjesh	621		Teknikët e pylltarisë kryejnë një sërë funksionesh teknike dhe mbikëqyrëse në mbështetje të punës kërkimore për pyjet dhe manaxhimit, prerjes dhe ruajtjes së tyre, si edhe mbrojtjes së mjedisit. Teknikët e pylltarisë mund të punësohen në ferma ose kompani të mëdha pyjore, si edhe në agjenci dhe institucione shtetërore përgjegjëse për pyjet.
142	S4-IV-17	Mbrojtje mjedisi pyjor	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Punonjës të pyjeve dhe sharrëxhinj	6210		Punonjësi/ja i/e pyjeve dhe sharrëxhinj është njohës i mirë dhe zbatues i teknikave të punimeve në fushën e pyjeve, mjedisit, florës, faunës dhe kullotave. Ai/Ajo është zbatues direkt i punimeve që kryhen në terren, në fushën e menaxhimit të ekonomisë pyjore dhe të trajtimit silvo-teknike të pyjeve, si dhe ato të shfrytëzimit të materialit drunor. Punëtori/ja i/e pyjeve mund të punësohet në sektorët pyjor të Drejtorive të Shërbimit Pyjor të Rretheve, në Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave të Qeverisjes Vendore, në subjektet private apo kompanitë që kryejnë punime në pyje.
143	T-II-25	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	Program 2-vjeçar studimi për punonjës gjysëm i kualifikuar (ndihmës)	Instalues dhe specialist shërbimesh të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	7422	Punonjësi/ja ndihmës/e në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK) organizon punën duke planifikuar radhën e punës, mjetet, materialet dhe pajisjet e punës sipas detyrës që i caktohet nga eprori. Ai/Ajo organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike, mirëmban dhe sistemon vendin e punës, dokumenton punën e kryer dhe raporton tek eprori. Punonjësi/ja ndihmës/e në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK) instalon pajisjet hardware, kryen instalimet e rrjetit, kryen instalimin dhe mirëmbajtjen e programeve (software-ve), si dhe kryen mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të pajisjeve hardware. Ai/Ajo mbështet përdoruesin dhe kryen procese të thjeshta për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave. Punonjësi/ja ndihmës/e në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK) komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera, në komunikimin me të tjerët.	
144	T1-IV-21	Rrjete të dhënash	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknikë të rrjetit kompjuterik	3513	Tekniku/ja i/e rrjetit instalon pajisjet pasive dhe aktive të rrjetit, kryen konfigurimin e pajisjeve të rrjetit dhe diagnostikimin e problemeve në rrjet duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura. Ai/Ajo, mirëmban dhe riparon rrjetin, zbaton politikat e sigurisë dhe kryen dokumentimin teknik të punës. Për realizimin e funksioneve të tij/saj, ai/ajo, në çdo rast ndjek procedura rigoroze të paraparacaktuar në udhëzuesit apo manualet teknike, ose nga specialistë të një niveli më të lartë. Tekniku/ja i/e rrjetit analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurisë së informacionit dhe sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
145	T2-IV-21	Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknikë për mbështetjen e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	3512	Tekniku/ja për mbështetjen e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit kryen montimet e kërkuara të pajisjeve fizike, instalon dhe konfiguron pajisjet fizike dhe programet përkatëse. Ai/Ajo ndihmon përdoruesit duke iu përgjigjur kërkesave të tyre me anë të telefonit, e-mail ose në prezencë. Ai/Ajo diagnostikon problemet e ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, mirëmban dhe riparon sistemet e TIK, monitoron mirë funksionimin e sistemeve, zbaton politikat e sigurisë dhe kryen dokumentimin teknik të punës. Për realizimin e funksioneve të tij/saj, ai/ajo, në çdo rast ndjek procedura rigoroze të paraparacaktuar në udhëzuesit apo manualet teknike, ose nga specialistë të një niveli më të lartë. Ai/Ajo azhornon inventarin e aseteve të TIK. Tekniku/ja për mbështetjen e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
146	T3-IV-21	Zhvillim website	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik website	3514	Tekniku/ja i/e website-it koncepton dizajnin dhe funksionalitet e faqes web, zhvillon front-end dhe back-end, përgatit platformën e hostimit, publikon, mirëmban faqen web, zbaton politikat e sigurisë dhe kryen dokumentimin teknik të punës. Për realizimin e funksioneve të tij/saj, ai/ajo, në çdo rast ndjek procedura rigoroze të paraparacaktuar në udhëzuesit apo manualet teknike, ose nga specialistë të një niveli më të lartë. Tekniku/ja i/e website-it analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	

147	T4-IV-21	Programim	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Asistent, programim kompjuteri	3512.02	Zhvilluesi/ja (niveli i mesëm) është një figurë profesionale i/e cila është përgjegjëse për dizenjimin, kodimin dhe modifikimin e programeve dhe sistemeve të ndryshme. Për të organizuar sa më mirë punën e tij/saj, ai/ajo bazohet në një layout të dhënë nga designer dhe menaxheri i projektit, i cili ka shënuar të gjitha funksionalitetet dhe specifikimet e klientit. Detyra bazë e një zhvilluesi/eje është të krijojë programe apo sisteme manaxhimi të bazuar në cloud që theksojnë ndërveprimin e thjeshtë të përdoruesit dhe një navigim të thjeshtë. Zhvilluesi/ja punon në grup dhe koordinon punën me pjesën tjetër të ekipit në mënyrë që projekti të eci me sukses. Ai/Ajo është gjithnjë në kërkim të trendeve më të fundit, të cilat më pas i implementon sipas dokumentacionit përkatës. Ai/Ajo jep ide për mënyrën se si duhet të strukturohet arkitektura e një aplikacioni dhe konsultohet me pjesën tjetër të ekipit për aspekte të tjera përtej funksionalitetit. Zhvilluesi/ja kryen instalime dhe konfigurime të të gjitha librarive dhe framework-ve në mënyrë që më pas të bëj testimin e kodit, për të parë gabime të mundshme dhe të implementojë API në rastet që është i nevojshëm. Ai/Ajo është pjesë e ekipit dhe komunikon konform të gjitha rregullave, duke respektuar normat e etikës dhe hierarkinë në kompani.	
148	T5-IV-21	Multimedia	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Teknik në multimedia	3512	Tekniku/ja për multimedia koncepton projektin dhe krijon produkte multimediale të bazuara në IT, siç janë faqet e internetit, DVD-të (foto, video, audio), përmbajtje për media digjitale, materiale të printueshme dhe lojëra kompjuterike që ndërthurin tekstin me tinguj, fotografi, grafikë, videoklipe dhe animacione digjitale, duke përdor një sërë paketash software të dizajnit kompjuterik. Ai/Ajo, mund të punojë vetëm apo me një ekip krijues të një kompanie për kryerjen e projekteve, konceptimin e planeve, identifikimin e trendeve të tregut, përgatitjen e mostrave për aprovimin nga klienti dhe zhvillimin e strategjive për të optimizuar operacionet, duke iu përmbajtur afateve kohore të projektit, buxhetit të caktuar, politikave dhe rregulloreve të kompanisë. Tekniku/ja për multimedia analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit, rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit,si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
149	T/1-IV-24	Inxhinieri informatike softwaresh	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Teknikë të proceseve të TIK dhe të mbështetjes së përdoruesve	351	Tekniku/ja i/e inxhinierisë software-ike, analizon, planifikon dhe organizon vendin e punës, kryen zbatimin dhe mirëmbajtjen e sisteme software-ike, planifikimin dhe zbatimin e rrjetit kompjuterik. Ai/Ajo programon aplikacione, zhvillon website dhe aplikacione web, kryen ndërtim, zbatim dhe mirëmbajtje të bazës së të dhënave dhe aplikon inteligjencë artificiale. Gjatë kryerjes së aktivitetit të vet, tekniku/ja i/e inxhinierisë software-ike zbaton elementët e sigurisë kompjuterike dhe kryen sigurim cilësie të sistemeve kompjuterike. Ai/Ajo përcakton radhën e punës, përzgjedh dhe përgatit veglat, pajisjet e punës, kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup, si dhe përgatit dhe plotëson dokumente për shërbimet e kryera. Ai/Ajo koordinon punën me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera, në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe ngre nivelin profesional.	
150	T/2-IV-25	Zhvillim website	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Zhvillues website (i mesëm)	3514	Zhvilluesi/ja i/e website (i mesëm) kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke analizuar detyrën, vendosur prioritetet në planin e punës, si dhe duke planifikuar burimet e nevojshme, radhën dhe kohën e punës. Ai/Ajo analizon kërkesat e projektit/klientit duke diskutuar apo intervistuar klientin për të mbledhur informacion lidhur me nevojat dhe objektivat, duke përmbledhur kërkesat teknike dhe funksionale, vlerësuar prioritizimin dhe realizueshmërinë e kërkesave, identifikuar palët e interesuara kryesore dhe duke përcaktuar kufijtë e projektit dhe funksionalitetet. Zhvilluesi/ja i/e website (i mesëm) ndërton prototipin, programon në front end dhe në back end. Ai/Ajo publikon web-in (hosting), teston programet/webistet dhe i mirëmban ato. Zhvilluesi/ja i/e website (i mesëm) kryen detyra administrative dhe tregtare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, koordinon punën me ekipin, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, si dhe ngre nivelin profesional.	
151	T/3-IV-25	Programim	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Programues (i mesëm)	2514.03	Programuesi/ja (i/e mesëm/me) kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke analizuar detyrën/detyrat (objektivat e përgjithshëm), vendosur prioritetet në planin e punës dhe duke planifikuar burimet e nevojshme. Ai/Ajo analizon kërkesat e projektit/klientit duke përcaktuar specifikimet teknike, duke përcaktuar detyrat specifike të zbatimit të projektit, duke mbështetur testimin e realizimit të funksionaliteteve dhe pranimit (UAT), si dhe duke përcaktuar prioritetet e kërkesave dhe ndryshimeve. Programuesi/ja (i/e mesëm/me) zhvillon ndërfaqen e aplikacionit (front end), logjikën e biznesit të sistemit (back end) dhe sisteme të thjeshta IA. Ai/Ajo realizon proceset operacionale të zhvillimit të aplikacionit, mirëmbajtjen e hapësirave hostuese dhe teston zhvillimet në aplikacione/sisteme. Programuesi/ja (i/e mesëm/me) kryen detyra administrative dhe tregtare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, koordinon punën me ekipin, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, si dhe ngre nivelin profesional.	
152	T/4-IV-25	Multimedia	Program 4 vjeçar për nivelin teknik/menaxher i mesëm	Teknik në multimedia	3512	Tekniku/ja për multimedia krijon dhe transmeton në kanale digjitale/tradicionale apo prodhim, produkte multimediale që ndërthurin elementët foto, video, audio, grafike, materiale për prezantim, materiale për printim, animacione dhe lojëra kompjuterike duke përdorur sisteme apo platforma përfshirë hardware dhe software në funksion të multimedias. Ai/Ajo mund të punojë vetëm apo me një ekip krijues të një kompanie për kryerjen e projekteve, konceptimin e planeve, identifikimin e trendeve të tregut, përgatitjen e mostrave për aprovimin nga klienti dhe zhvillimin e strategjive për të optimizuar operacionet, duke iu përmbajtur afateve kohore të projektit, buxhetit të caktuar, politikave dhe rregulloreve të kompanisë. Tekniku/ja për multimedia analizon, planifikon, organizon dhe koordinon punën me kolegë dhe me eprorë, duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. , në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/Ajo zbaton politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit, rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
153	T/5-IV-26	Rrjete të dhënash dhe sisteme kompjuterike	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik të rrjetit kompjuterik dhe sistemeve	3513	Tekniku/ja i/e rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke filluar me informimin dhe analizimin e kërkesave/detyrave të ngarkuara, me planifikimin dhe përzgjedhjen e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, me planifikimin e kohës dhe radhës së punës dhe kontrollin e funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve të punës. Ai/Ajo kryen mirëmbajtjen dhe sistemimin e vendit të punës, bashkëpunon me specialistë të tjerë, si dhe raporton për punën e kryer. Tekniku/ja i/e rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike identifikon infrastrukturën e rrjetit, kryen instalimin dhe konfigurimin e rrjetit, kryen riparime të pajisjeve dhe lidhjeve në rrjet, si dhe kryen dokumentimin e konfigurimeve/arkitekturës së rrjetit. Ai/Ajo mirëmban teknikën e rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, implementon masat dhe politikat e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, si dhe përdor IA (Inteligjencën Artificiale) për realizimin e proceseve të punës me efiçiencë dhe efektivitet. Tekniku/ja i/e rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Tekniku/ja i/e rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
154	T1-V-24	Siguri kibernetike	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Teknik i lartë i proceseve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për sigurinë kibernetike	3511.01	Specialisti/ja për sigurinë kibernetike kryen planifikimin, organizimin dhe dokumentimin e punës nëpërmjet analizimit të detyrës, planifikimit dhe përzgjedhjes së burimet njerëzore, mjeteve, materialeve, pajisjeve të punës, planifikimit të kohës së punës, si dhe raportimit në kohën e duhur tek eprorët. Specialisti/ja për sigurinë kibernetike implementon, vlerëson dhe monitoron sistemet e sigurisë kibernetike. Ai/Ajo instalon pajisjet e sigurisë, software-t e sigurisë dhe teston funksionalitetin e pajisjeve dhe software-ve të instaluar. Specialisti/ja për sigurinë kibernetike kontrollon funksionalitetin e infrastrukturës IT, funksionalitetin e rrjetit të komunikimit dhe konfigurimet e sistemeve të sigurisë kibernetike. Ai/Ajo monitoron dhe analizon Log-et, analizon trafikun në rrjet dhe kryen kontrollin periodik të politikave të sigurisë. Specialisti/ja për sigurinë kibernetike zbaton një sërë masash për reagim ndaj anomalive si: përditësimi i sisteneve dhe pajisjeve të sigurisë kibernetike, kryerja e skanimit periodik të sistemeve kompjuterike, verifikimi i sigurisë së sistemit dhe përdoruesve dhe jep rekomandime për përmirësime të sigurisë. Ai/Ajo merr masa për parandalimin e anomalive si: bllokimi i user-ave në sistem kur janë të kompromentuar, shkëputja e komunikimit në rrjet të pajisjes së kompromentuar, skanimi i rrjetit për anomali të njëjta dhe analizimi i makinës/userit për efektet e ndodhura gjatë sulmit. Specialisti/ja për sigurinë kibernetike diskuton me kolegët dhe eprorët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton të gjithë legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
155	T2-V-25	Mbështetje për përdorimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	Program, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Asistent informacioni në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike (IT Support Specialist)	3512.01	Asistenti/ja i/e informacionit në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike kryen planifikimin dhe organizimin e punës duke hartuar/zbatuar projekte të thjeshta, planifikuar nevojat teknike lidhur me proceset e punës dhe burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale. Ai/ Ajo bashkëpunon me specialistë të tjerë, dokumenton punën e kryer dhe raporton tek eprori. Asistenti/ja i/e informacionit në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike kryen instalimin dhe konfigurimin e hardware, instalimin dhe konfigurimin e software, mirëmban hardware dhe software, si dhe zgjidh problemet hardware dhe software. Ai/Ajo asiston përdoruesit fundorë dhe administron sistemet e menaxhimit dhe authentifikimit të përdoruesve. Asistenti/ja i/e informacionit në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike kryen detyra administrative dhe financiare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët, në përputhje me politikat e organizatës dhe ligjet në fuqi. Ai/ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.	
156	U-IV-25	Shërbime kujdesi për të moshuar	Program 4-vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Kujdestar për të moshuarit	5323.02	Kujdestari/ja për të moshuarit, në shtëpi private dhe në rezidenca të pavarura, është përgjegjës/e për menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të institucionit, përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, kohore dhe materiale, me qëllim që përfituesit të marrin shërbime cilësore, në përputhje me nevojat e tyre dhe me standardet për ofrimin e shërbimeve social-shëndetësore. Kujdestari/ja për të moshuarit kryen planifikimin, organizimin dhe koordinimin e punës, si dhe monitoron sigurimin e higjienës së të moshuarit, procesin e ushqyerjes, aktivitetet argëtuese dhe informuese, procesin e komunikimit me familjen/të afërmit e të moshuarit. Ai/Ajo asiston në përkujdesjen e shëndetit të të moshuarit, merr masa për sigurimin e një mjedisi fizik të sigurt dhe të aksesueshëm për të moshuarin, si dhe garanton respektimin e të drejtave të të moshuarve. Kujdestari/ja për të moshuarit, kryen detyra administrative dhe tregtare, komunikon në mënyrë etike dhe profesionale, me eprorët, kolegët, stafin dhe përfituesit e shërbimit, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj. në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.	
157	V-II-20	Termohidraulikë	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës ndihmës në termohidraulikë	712	Ndihmësi/ja në termohidraulikë organizon vendin e punës duke përzgjedhur mjetet, veglat, pajisjet e punës, materialet e punës, makineritë e nevojshme, duke transportuar mjetet, materialet dhe pajisjet gjatë punës, si dhe duke pastruar dhe sistemuar veshjet, veglat dhe vendin e punës para, pas dhe gjatë punës. Ndihmësi/ja në termohidraulikë ndihmon në instalimet termohidraulike, në instalimin e linjave të brendshme, në instalimin e pajisjeve hidrosanitare, në instalimin e linjave të jashtme, në testimin e linjave dhe sistemeve, si dhe në riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve. Ndihmësi/ja në termohidraulikë raporton verbalisht në mënyrë të vazhdueshme për punën e kryer dhe zbaton me korrektësi udhëzimet e eprorëve. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët dhe eprorët, zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj, si dhe zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	

158	V1-III-21	Instalime hidraulike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Hidraulik në banesa	7126	Hidrauliku/ja analizon, planifikon dhe organizon punën, përgatit vendin e punës, instalon linjat e brendshme të furnizimit me ujë, instalon linjat e shkarkimit të ujërave të përdorura dhe të ajrimit, si dhe linjat e mbledhjes dhe shkarkimit të ujërave të reshjeve. Ai/Ajo instalon linjat e hidrantëve të brendshëm, instalon pajisje hidrosanitare të ndryshme, kryen riparime të defekteve të linjave të furnizimit me ujë dhe të shkarkimit, pajisjeve hidrosanitare, si dhe mirëmban linjat e furnizimit dhe shkarkimit në objekte banimi dhe prodhimi industrial. Hidrauliku/ja kryen matje, shënjime, kuotime duke përdorur pajisjet e duhura, prerje, filetime, lakime, bashkime, lidhje të tubave, instalime dhe montime të armaturave, pompave, depozitave, pajisjeve të ndryshme dhe hidrosanitare, lokalizon dhe riparon defektet duke përdorur teknika të ndryshme, realizon provat hidraulike për funksionimin e linjave dhe pajisjeve hidrosanitare të instaluara. Përpara instalimeve, ai/ajo lexon dhe interpreton projektin, e ballafaqon projektin me objektin konkret në terren, diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët dhe sugjeron ndryshime, harton skema të thjeshta, përgatit bazën materiale për punën që do të kryejë, përcakton radhën e punës në objekt, si dhe përzgjedh veglat dhe pajisjet e punës. Ai/Ajo kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet që do të kryejë, bashkërendon punën në grup për t'iu përmbajtur afateve kohore të përcaktuara dhe buxhetit, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Hidrauliku/ja analizon, planifikon dhe koordinon punën me grupet e tjera për instalimet e ndryshme të infrastrukturës në objekt, me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
159	V2-III-21	Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse	7127	Instaluesi/ja i/e sistemeve ngrohëse-ftohëse analizon, planifikon dhe organizon punën, përgatit vendin e punës, instalon linjat e sistemeve të ngrohjes me kaldajë, ngrohje-ftohjes HVAC dhe sistemeve të kombinuara me panele diellore, instalon linjat e nxjerrjes së gazrave, si dhe linjat e mbledhjes dhe shkarkimit të ujërave të kondensimit, instalon pajisje dhe trupa pune ngrohëse-ftohëse të ndryshme. Ai/ Ajo kryen mirëmbajtjen dhe riparimin e defekteve në linjat e sistemeve të ngrohjes me kaldajë, ngrohje-ftohjes HVAC dhe sistemeve të kombinuara me panele diellore, si dhe linjat e nxjerrjes të gazrave dhe të mbledhjes, shkarkimit të ujërave në objekte banimi, biznesi, social-kulturore etj. duke përdorur teknika të ndryshme sipas udhëzimeve, si dhe realizon provat për funksionimin e linjave. Instaluesi/ja i/e sistemeve ngrohëse-ftohëse kryen matje, shënjime, kuotime duke përdorur pajisjet e duhura, prerje, filetime, lakime, bashkime, lidhje të tubave, instalime dhe montime të armaturave, pompave, depozitave dhe pajisjeve të tjera të sistemeve të ngrohjes me kaldajë, ngrohje-ftohjes HVAC dhe sistemeve të kombinuara me panele diellore. Përpara instalimeve, ai/ajo lexon dhe interpreton projektin, e ballafaqon atë me objektin konkret në terren, diskuton me kolegët, eprorët dhe klientët, përgatit bazën materiale për punën që do të kryejë, si dhe përzgjedh veglat dhe pajisjet e punës, kryen hulumtime të tregut, përgatit preventivin për punimet, bashkërendon punën në grup për t'iu përmbajtur afateve kohore të përcaktuara dhe buxhetit, përgatit dhe plotëson dokumentet për dorëzimin e punimeve të kryera. Instaluesi/ja i/e sistemeve ngrohëse-ftohëse koordinon punën me grupet e tjera për instalimet e ndryshme të infrastrukturës në objekt, me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, zbaton udhëzimet përkatëse, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera.	
160	V3-III-22	Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Hidraulik në ujësjellës kanalizime	7126	Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime kryen punime hidraulike sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventive ose në projektin e zbatimit. Ai/Ajo analizon, planifikon dhe organizon punën, shtron linjat e ujësjellësit të jashtëm, monton nyjën ujëmatëse, shtron linjat e rjetit të jashtëm të kanalizimit, si dhe kryen riparime të shkarkuesve, ajruesve, pusetave kryesore, nyjeve hidroteknike, saraçineskave në linja transmetimi, linja shpërndarëse etj.. Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime eliminon humbjet në linjat e transmetimit dhe linjat shpërndarëse, kryen manovrime të saraçineskave kryesore të rjetit, matje të presionit në pika të ndryshme të rjetit, montime të ujëmatësve etj. Ai/Ajo gjatë punës së tij diskuton me kolegët, eprorët dhe teknikë të tjerë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera, në komunikimin me të tjerët. Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime zbaton bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale hidraulike, regullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit, si dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë. Ai/Ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e hidraulikës.	
161	V4-III-26	Instalime hidraulike	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Hidraulik në banesa	7126	Hidrauliku/ja në banesa kryen planifikimin dhe organizimin e punës pasi ka njohur vendin e kryerjes së punimeve dhe ka interpretuar dokumentacionin teknik/projektin/skicat. Ai/Ajo planifikon dhe përzgjedh mjetet, materialet, pajisjet dhe instrumentet e punës, përcakton radhën dhe kohën e punës, kryen pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, bashkëpunon me specialistë të tjerë, si dhe raporton për punën e kryer. Hidrauliku/ja në banesa kryen punime përgatitore, instalon linjat e rrjeteve të brendshme hidraulike, monton pajisjet e rrjeteve të brendshme hidraulike, si dhe instalon sistemet me panele diellore për ujë të ngrohtë sanitar. Ai/Ajo kryen mirëmbajtjen, riparimet dhe testimet e rrjetit. Hidrauliku/ja në banesa kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Hidrauliku/ja në banesa ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
162	V5-III-26	Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Instalues i sistemeve ftohëse - ngrohëse	7127	Instaluesi/ja i/e sistemeve ftohëse-ngrohëse kryen planifikimin dhe organizimin e punës pasi ka njohur objektin ku do të kryhen punimet dhe ka interpretuar dokumentacionin teknik, planet dhe skemat. Ai/Ajo planifikon dhe përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, kryen pastrimin dhe sistemimin e veshjeve, veglave dhe vendit të punës, bashkëpunon me specialistë të tjerë, si dhe raporton për punën e kryer. Instaluesi/ja i/e sistemeve ftohëse-ngrohëse kryen punime përgatitore, realizon provat e sistemit, si dhe mirëmban dhe riparon sistemet ftohëse-ngrohëse. Ai/Ajo instalon tubacionet, instalon njësitë e trajtimit të ajrit, si dhe instalon pajisjet e brendshme. Instaluesi/ja i/e sistemeve ftohëse-ngrohëse kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Instaluesi/ja i/e sistemeve ftohëse-ngrohëse ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
163	V6-III-26	Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime	Program 3 vite për punonjës të kualifikuar	Hidraulik në ujësjellës kanalizime	7126	Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime kryen planifikimin dhe organizimin e punës, duke filluar me informimin mbi projektin/objektin/terrenin ku do të kryhen punimet, me planifikimin dhe përzgjedhjen e bazës materiale të nevojshme, me transportimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, verifikimin e materialeve dhe kontrollin e funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve të punës. Ai/Ajo kryen pastrimin dhe sistemimin e veshjeve, veglave dhe vendit të punës para, pas dhe gjatë punës, bashkëpunon me specialistë të tjerë, njofton eprorin në raste defektesh/avarish, si dhe raporton për punën e kryer. Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime kryen operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë, operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, si dhe operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave të shiut. Ai/Ajo kryen instalimin e sistemit të furnizimit me ujë, instalimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, instalimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut dhe instalimin e ujëmatësave. Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime kryen një sërë detyrash administrative dhe financiare, si dhe dokumenton vazhdimisht punën e kryer. Ai/Ajo komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me të tjerët, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë, rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Hidrauliku/ja në ujësjellës kanalizime ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe duke u përditësuar me teknologjitë e reja dhe zhvillimet e fushës.	
164	V-IV-23	Termohidraulikë	Programe 1-vjeçare studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknik/inxhinieri civile (hidraulik)	3112.09	Tekniku/ja hidraulik/e ndjek instalimin dhe montimin e sistemeve termo-hidraulike, të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri dhe pajisjeve hidraulike të specializuara si: pishina terapeutike, dhoma me avull, poltrone dentare dhe pishina të zakonshme, ndërtim të shkarkimeve, kullimeve, kanalizimeve. Ai/Ajo merr masa për sigurimin e përmbushjes së specifikimeve të projektit, të regullave përkatëse, si dhe për ruajtjen e standardeve të kërkuara për materialet dhe punën e kryer. Tekniku/ja hidraulik/e ndjek inspektimin përfundimtar dhe vënien në punë të përbërësve përkatës, sipas rregulloreve aktuale dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga projektuesi. Ai/Ajo ndjek mirëmbajtjen periodike të sistemeve dhe riparimin e çdo defekti, zbaton njohuritë teknike të fushave të ndërtimit, hidroteknikës dhe të termohidraulikës, si dhe të parimeve të tyre për të identifikuar dhe zgjidhur problemet që mund të dalin. Tekniku/ja hidraulik/e përgatit preventivë të detajuar për sasitë dhe kostot e materialeve dhe të punës së duhur për projekte të caktuara, bazuar në specifikimet e dhëna, organizon planin e punës për mirëmbajtjen dhe riparimet, inspekton instalimet termohidraulike të ndërtuara gjatë dhe pas përfundimit të ndërtimit për të garantuar që ato janë në përputhje me specifikimet, si edhe me regulla të tjera, që kanë të bëjnë me cilësinë dhe sigurinë e objektit. Ai/Ajo komunikon rezultatet tek eprori me anë të raporteve ditore, javore dhe mujore, respekton politikat e brendshme të punës dhe procedurat e hartuara nga kompania, zbaton kodin e etikës të miratuar nga drejtuesit, zbaton rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit, si dhe zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.	
165	X-II-20	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punëtor të shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to	8113		Punëtorët e shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to montojnë dhe drejtojnë makinerinë e shpimit dhe pajisjeve që lidhen me to për hapjen e puseve, nxjerrjen e mineraleve jo metalike, lëngjeve dhe gazrave ose për një sërë qëllimesh të tjera. Punëtorët e shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to çmontojnë, lëvizin dhe montojnë pajisjet e shpimeve dhe pajisjet ndihmëse, montojnë dhe çmontojnë tuba, zorrë, pajisjen shpuese dhe zëvendësojnë pajisjet jofunksionale, si dhe drejtojnë kontrolluesit për të ulur ose ngritur tubat e shpimit dhe zorrëve brenda dhe jashtë puseve, rregullojnë presionin në puse dhe kontrollojnë shpejtësinë e mjeteve. Ata përgatisin lëngun e shpimit dhe kontrollojnë funksionimin e pompave për të siguruar qarkullimin e duhur të lëngjeve në tubat e shpimit dhe pusin, monitorojnë standardet dhe tregues të tjerë, dëgjojnë pajisjet për të zbuluar ndonjë keqfunksionim dhe kushte të pazakonta të pusit dhe përcaktojnë nevojën për ndryshimin e pajisjes shpuese, mirëmbajnë, përshtatin, riparojnë dhe pastrojnë pajisjet e shpimit e sondat, krikun dhe makineri të tjera, si dhe regjistrojnë proceset e shpimit dhe ndihmojnë në detyra të tjera. Ata drejtojnë makinat dhe mjetet për heqjen e pluhurit, pajisjeve të thyera ose të dëmtuara nga vrimat ose puset, si dhe mbyllin dhe vulosin puset që nuk do të jenë më në përdorim.
166	X2-III-16	Shpim i puseve të naftës, gazit dhe ujit	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor të shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to	8113		Punëtorët e shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to montojnë dhe drejtojnë makinerinë e shpimit dhe pajisjeve që lidhen me to për hapjen e puseve, nxjerrjen e mineraleve jo metalike, lëngjeve dhe gazrave ose për një sërë qëllimesh të tjera. Punëtorët e shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to çmontojnë, lëvizin dhe montojnë pajisjet e shpimeve dhe pajisjet ndihmëse, montojnë dhe çmontojnë tuba, zorrë, pajisjen shpuese dhe zëvendësojnë pajisjet jofunksionale, si dhe drejtojnë kontrolluesit për të ulur ose ngritur tubat e shpimit dhe zorrëve brenda dhe jashtë puseve, rregullojnë presionin në puse dhe kontrollojnë shpejtësinë e mjeteve. Ata përgatisin lëngun e shpimit dhe kontrollojnë funksionimin e pompave për të siguruar qarkullimin e duhur të lëngjeve në tubat e shpimit dhe pusin, monitorojnë standardet dhe tregues të tjerë, dëgjojnë pajisjet për të zbuluar ndonjë keqfunksionim dhe kushte të pazakonta të pusit dhe përcaktojnë nevojën për ndryshimin e pajisjes shpuese, mirëmbajnë, përshtatin, riparojnë dhe pastrojnë pajisjet e shpimit e sondat, krikun dhe makineri të tjera, si dhe regjistrojnë proceset e shpimit dhe ndihmojnë në detyra të tjera. Ata drejtojnë makinat dhe mjetet për heqjen e pluhurit, pajisjeve të thyera ose të dëmtuara nga vrimat ose puset, si dhe mbyllin dhe vulosin puset që nuk do të jenë më në përdorim.

167	X1-III-23	Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor të shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to	8113	Punëtori/ja i/e shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to përgatit vendin e punës duke përzgjedhur mjetet, pajisjet dhe instrumentet e punës sipas procesit të punës, duke ndarë detyrat në ekip, organizuar vendin e punës në mënyrë ergonomike, si dhe duke bashkëpunuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës. Ai/Ajo monitoron prodhimin e grupit të puseve, zbaton metodat e dyta në shfrytëzimin e puseve, kryen injektimin e holluesit në puset e prodhimit, kryen transportin (pompimin) e fluidit, realizon trajtimin e fluideve të nxjerra nga puset dhe kryen remontin sipërfaqësor dhe nëntokësor të puseve. Punëtori/ja i/e shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to raporton tek eprorët për ecurinë e punës dhe dokumenton, sipas formateve të përcaktuar, proceset e kryera. Ai/Ajo bashkëpunon me kolegë dhe me eprorë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së punimeve të kryera. Ai/Ajo ndërhyn dhe merr masa në rastin e konstatimit të veprimeve që cënojnë parimet e sigurisë, ose parimeve që bien në kundërshtim me rregulloren e brendshme të kompanisë.	
168	X-IV-25	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë	Programe 1-vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknik të shpim - shfrytëzimit të vendburimeve të naftës, gazit dhe ujit	3135	Tekniku/ja i/e shpim-shfrytëzimit të vendburimeve të naftës, gazit dhe ujit kryen planifikimin, organizimin dhe koordinimin e punës duke planifikuar proceset e punës, radhën dhe kohën e punës, duke planifikuar dhe përzgjedhur mjetet, makineritë, materialet, pajisjet e punës dhe burimet njerëzore të nevojshme, si dhe duke ndarë detyrat në ekip. Ai/Ajo koordinon punën me specialistë të tjerë, dokumenton punën e kryer, si dhe raporton rregullisht për ecurinë e punës. Tekniku/ja i/e shpim-shfrytëzimit të vendburimeve të naftës, gazit dhe ujit mbikëqyr procesin e shpimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit, mbikëqyr procesin e shfrytëzimit (nxjerrjes) të naftës, mbikëqyr procesin e shfrytëzimit (nxjerrjes) të gazit natyror, mbikëqyr procesin e shfrytëzimit (nxjerrjes) të ujit, si dhe monitoron cilësinë e punimeve. Ai/Ajo kryen detyra administrative dhe tregtare si dhe komunikon në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët, vartësit dhe komunitetin. Ai/Ajo zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	